



 **Partia  
Demokratike  
e Shqipërisë**

Mos Harro Nr.9  
Partia Demokratike



Mos Harro  
Nr.6 Roland Bejko

**ROLAND  
BEJKO**

PROGRAMI

**2023-2027**

ZGJEDHJET LOKALE, 14 MAJ 2023

FRYMËMARRJE PËR **TIRANËN**

## Që Tirana dhe demokracia të marrin frymë...

Ky është programi im për zgjedhjet lokale të Tiranës 14 Maj 2023. Jo thjesht fryt i përvojës sime më shumë se 20 vjet në pushtetin lokal, i ekspertizës sime në administrimin publik apo në çështje politike, por edhe fryt i bashkëpunimit me më shumë se 15 ekspertë të nderuar, figura të shquara të këtyre fushave. Programi ynë bazohet mbi një kompetencë të lartë, mbi njohjen e realitetit, mbi shifrat kyçe të sektorëve dhe të të dhënave të tjera karakterizuese të jetës së Tiranës së madhe.

Nga ana tjetër, programi ka një frymëzim thelbësisht të djathtë; ai, jo vetëm evidenton politikën, qasjen apo filozofinë e gabuar të qeverisjes aktuale të Tiranës nga kryetari aktual Erion Veliaj, por propozon me një frymë të re filozofinë e vet. Programi evidenton gjithashtu problemet kryesore të fushës si dhe propozon zgjidhje të mëdha të tyre, për të ndryshuar realitetin e zymtë në shumicën dërrmuese të sektorëve që përbejnë jetën e kryeqytetit. Po ashtu, programi ka një propozim të madh bazë për çdo fushë, duke u përpjekur ta çojë modestish Tiranën një nivel tjetër.

Të nderuar zgjedhës, të nderuar aktorë shoqërorë apo institucionalë, ky është programi, që Partia Demokratike e Shqipërisë, partia historike e ndryshimit, partia e studentëve, partia e intelektualëve të dhjetorit të vitit 1990, i propozon Tiranës në këtë moment të rëndësishëm për një ndryshim thelbësor politik, për t'i dhënë fund kastës tridhjetë e ca vjeçare në drejtimin e Shqipërisë apo Tiranës, për t'i dhënë fund zgjatimeve të krimit të organizuar, të korrupsionit, të interesave të oligarkisë në kryeqytetin tonë, në kryeqytetin e Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Shkurt, ky program është në përputhje me filozofinë e fushatës sime:

Frymëmarrje për Tiranën!

Ju faleminderit!

**Roland Bejko**





# 1 ARSIMI PARAUNIVERSITAR DHE UNIVERSITAR

“Tirana Student Friendly City”, krijimi i infrastrukturës për të pritur në Tiranë deri në 250.000 studentë shqiptarë dhe të huaj deri në vitin 2030

# 1. ARSIMI PARAUNIVERSITAR DHE UNIVERSITAR

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

1. Në Bashkinë Tiranë ka 94 shkolla publike gjithsej. Këtu përfshihen shkollat nëntëvjeçare, gjimnazet, shkollat e mesme profesionale dhe Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë.
2. Edhe pse Bashkisë Tiranë iu disbursuan rreth 6 miliardë lekë nga 11 miliardë nga Fondi i Rindërtimit, gjithashtu dhe nga FSHZH (Fondi Shqiptar i Zhvillimit), Donacione, Fondi Qatar, Qeveria sllovaqe, Çekia, Edu4School, shkollat e cilësuar si të dëmtuara nga tërmeti i 2019-ës ende nuk janë përfunduar, duke vështirësuar procesin normal mësimor, pasi nxënësit bëjnë mësim me turne në shkolla të tjera prej tri vitesh, ku gjatë pandemisë mësimi u zhvillua edhe me katër turne.
3. Ndërkohë, Bashkia Tiranë mbledh taksë për infrastrukturën shkollore me një vlerë prej 42 milion euro në 7 vitet e fundit.
4. Ngrohja në shkolla vazhdon të mbetet problem, edhe pse janë bërë rikonstruksione shkollash dhe janë ndërtuar shkolla të reja. Ngrohja me pelete, aty ku ka funksionuar, ka qenë e reduktuar vetëm në orët e para të mësimt, ndërkohë që kaldajat kanë shfaqur probleme serioze duke vënë në rrezik jetën e nxënësve. Ndotja e ajrit dhe mungesa e ajrit në shkolla mbeten një tjetër problem. Përsa u përket ambienteve për të konsumuar ushqim, mensa nuk është konceptuar në asnjë shkollë publike.
5. Studentët e universiteteve publike dhe jo publike ende nuk përfitojnë shërbimet që karta e studenteve duhet t'u garantonte, dhe nga 28 godina në Qytetin Studenti janë restauruar 11-12 të tilla. Edhe pse studentët protestuan më 2018-ën, jetesa e tyre në konvikte është e vështirë duke i detyruar ata të marrin shtëpi me qira. Gjysma e godinave të Qytetit Studenti kanë kushte mesjetare, por edhe godinat e restauruara nuk janë në parametra bashkëkohorë të shfrytëzimit të resurseve natyrore të energjisë.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Mbipopullim në shkolla, mësimi me dy turne.
- 2- Dendësia e ajrit për metër kub për nxënës jashtë parametrave normalë
- 3- Mungesa e ngrohjes dhe mungesa e pastrimit të ajrit;
- 4- Karta studentore me shërbime mbështetëse jo funksionale;
- 5- Kushte mesjetare në konviktet studentore dhe mungesa e menaxhimit dhe zgjidhjes me konvikte alternative për studentët.

## III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJA E SEKTORIT

Filozofia e ndjekur është: Dukje e propagandë dhe jo thelb, mashtrim dhe jo transparencë, investime të shpejta, jo cilësore e jo bashkëkohore afatshkurtra pa vizion për perspektivën. Erion Veliaj premtoi “çdo ditë nga një shkollë” dhe “shkolla me një turn” që në 2016-ën, dhe sot shkollat vazhdojnë me dy turne dhe të tejmbushura jashtë kapacitetit. Edhe pse janë rikonstruktuar, rindërtuar dhe ndërtuar shkolla të reja, cilësia e tyre dhe sistemi i ngrohjes, ajrit dhe pastrimit të ajrit nuk janë në parametra bashkëkohorë të shfrytëzimit të resurseve natyrore, duke dëshmuar se propaganda dhe reklama janë boshti i filozofisë së kryetarit aktual të bashkisë.

## IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJJA

Nuk mund të abuzohet e të vidhet në emër të rinisë. Tirana është kryeqyteti i rinisë, çka bën që ky qytet të jetë plot ngjyra dhe shpresë. Kushtet e mësimdhënies dhe të qëndrimit në mjediset e formimit duhet të jenë moderne, inovative, plot dritë dhe ngrohtësi. Propagandat boshe do të zëvendësohen nga aktivitete të plota në fushën e muzikës, artit, kulturës, dhe mësimi nëpërmjet argëtimit.

## V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

1. Karta e studentit do të jetë së shpejti një realitet funksional i cili do të shoqërohet me listën e të gjitha përfitimeve dhe lehtësirave që do t'i jepet çdo studenti universitar dhe çdo nxënësi të shkollës së mesme mbi moshën 16 vjeç.
2. Konviktet e Qyteti Studenti do të restaurohen tërësisht, dhe mbi to do të montohen panele diellore në funksion të ngrohjes dhe prodhimit të energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë do të ndërtohen konvikte të reja për shkollat e mesme profesionale, të cilat të tërheqin nxënësit e tyre jo thjesht nga Tirana, por nga e gjithë Shqipëria.
3. Në procesin e restaurimit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, shpeshherë të ndihmuara nga financime me donatore ndërkombëtare, do të shihet mundësia, sipas rastit, për zgjerimin dhe modernizimin e mjediseve të tyre duke kryer instalime që ruajnë temperaturën, dhe do të adoptohen teknika të reja të mësimdhënies.

# 150 000 STUDENTË

Përgatitje e infrastrukturë për të pritur 150 mijë studentë shqiptarë dhe të huaj brenda vitit 2023



## 2 ARSIMI PARASHKOLLOR

“Hartë shkollore”, çerdhe dhe kopshte funksionale sipas parimit : Jo më tepër se 15 min larg

## 2. ARSIMI PARASHKOLLOR

### I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

1. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Qëndrimi i fëmijëve në kopsht nënkupton integrim social dhe formim pedagogjik. Gati të gjitha elementet që duhet të garantojnë mirërritjen e fëmijëve, rezultojnë të jenë jashtë standardeve, që nga mbipopullimi tej kapaciteteve, kushtet higjieno-sanitare, mjetet didaktike e shumë të tjera, - nxjerrë në dritë audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit pas një monitorimi 5-mujor në kopshtet e çerdhet e Tiranës.
2. Popullsia e Tiranës është rritur shumë në numër krahasuar me vitin 1989, por çerdhe dhe kopshte të reja në qytetin Tiranës nuk janë ndërtuar me ritmin e rritjes së popullsisë. Para viteve '90 në Tiranë kishte rreth 60 kopshte. Më 2013 Tirana kishte 40 kopshte dhe kërkesat për t'u regjistruar ishin për 23 mijë fëmijë, ndër të cilët vetëm 4 mijë prej tyre patën mundësi të futeshin në kopshtet bashkiake.

Sipas Opendata (2020) kopshtet dhe çerdhet në Bashkinë Tiranë:

Treguesi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Gjithsej	83	85	79	79	81
Çerdhe	31	33	34	34	36
Kopshte me drekë	44	44	37	38	40
Kopshte pa drekë	8	8	8	7	5

3. Ngrohja në kopshte bëhet me kaldaja dhe kondicioner me orare të reduktuara. Gjatë stinës së verës në kopshte ka probleme me temperaturat e larta. Shfrytëzimi i resurseve natyrore për ngrohje dhe qarkullimin e pastrimit të ajrit nuk është praktikuar gjatë rikonstruksionit të kopshteve apo dhe në ndërtimet e reja.
4. Ambientet në kopshte janë të papërshtatshme për një edukim të mirë të fëmijëve. Grupet e kopshtit shkojnë nga 35-50 fëmijë. Këto shifra janë jashtë kapaciteteve dhe standardeve. Fëmijët luajnë, mësojnë dhe ushqehen në të njëjtin ambient. Gjithashtu, në disa kopshte ka numër të kufizuar të shtretërve, ku dy fëmijë flenë në një shtrat.
5. Programi mësimor i një pjese të klasave përgatitore për fëmijët e moshës 5-6 vjeç zhvillohet ende në kopshte, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e tij zhvillohet në shkolla. Kjo ka sjellë standarde të dyfishta dhe pengesa në miredukimin e fëmijëve të së njëjtës moshë.

### II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

1. Mbiipopullim në kopshte, siguria e fëmijëve në rrezik.
2. Dendësia e madhe dhe vëllimi i ajrit për metër kub për fëmijë jashtë parametrave normalë, mungesë të qëndrueshme ngrohjeje dhe mungesë ajrimi.
3. Mungesa e ambienteve komode, dhe të ndara për lojëra, mësim, ushqim dhe fjetje.
4. Mungesa e mjeteve didaktike.
5. Një pjesë e madhe e klasave përgatitore (mosha 5-6 vjeç) vazhdon ende në ambientet e kopshteve.

### III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJJA E SEKTORIT

Filozofia e ndjekur është: fasadë e propagandë dhe jo thelb, mashtrim dhe jo transparencë, investime të shpejta, jo cilësore e jo bashkëkohore. Investimet janë afatshkurtra e pa vizion dhe të shkëputura nga perspektiva. Çerdhet dhe kopshtet janë fillesa e edukimit të fëmijëve, por nga Bashkia Tiranë, përveç propagandës, vëmendja për këtë cikël edukimi ka qenë e munguar.

### IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJJA

Decentralizim i pushtetit dhe transparencë në vendimmarrje, marrje përgjegjësie dhe llogaridhënie. Njësia bazë e qeverisjes vendore është përgjegjëse për regjistrimin e fëmijëve në kopshte e çerdhe dhe mbarëvajtjen e procesit të edukimit. Komunikimi i hapur dhe i vazhdueshëm me çerdhet dhe kopshtet dhe komunitetin e prindërve për shërbimet që ofron, ku përmes vërejtjeve dhe sugjerimeve të prindërve të përmirësojë shërbimet për një edukim sa më të mirë të fëmijëve në moshë të hershme 0-3 dhe 3-5 vjeç. E ardhmja e Kombit duhet të rritet dhe zhvillohet në struktura cilësore e të sigurta sipas standardeve të Bashkimit Europian!

### V – TRI PREMTIME & PROPOZIME KONKRETE

1. Shërbimi "15 min larg shtëpisë" bazuar në Hartën e Çerdheve dhe Kopshteve sipas rrezes së vendbanimit të fëmijëve do të sillte shpërndarje të kontrolluar të numrit të fëmijëve në to, dhe marrja e ambienteve me qira është zgjidhje emergjente, krahas ndërtimit të çerdheve dhe kopshteve të reja. Kjo do të sillte:
  - a) Ulje të numrin të madh të fëmijëve dhe rritje të sigurisë së tyre (domosdoshmëri);
  - b) Hapësirë të nevojshme për ajër për metër kub për fëmijë (jetike);
  - c) Hapësirë për ambiente të ndara për të luajtur, mësuar, ushqyer dhe për të fjetur.
  - d) Lehtësim të trafikut, pasi një pjesë e fëmijëve vijnë nga zona të ndryshme për arsye të mungesës së shërbimeve afër vendbanimeve të tyre, prindër që punojnë në Bashki, prindërve në administratën shtetërore ose që kanë biznesin apo qendrën e punës pranë kopshteve dhe çerdheve.
2. Do të ndërtohen 10 çerdhe dhe kopshte të reja në mënyrë të balancuar midis qendrës së qytetit dhe lagjeve periferike duke u ardhur në ndihmë njerëzve që punojnë. Nga këto kopshte dhe çerdhe, dy prej tyre do të jenë domosdoshmërisht të vendosura pranë zonës industriale të autostradës Tiranë-Durrës, ku prindërit që punojnë në këtë zonë do ta kenë më të lehtë të çojnë dhe të marrin fëmijët e tyre.
3. Shqipëria me pozicionin e saj gjeografik, ku dielli është prezent 76% në vit ose 280 ditë në vit, na fton të përfitojmë nga gjithë kjo energji alternative, duke përdorur panele diellore për energji dhe ngrohje. Kudo që të ketë mundësi, në kopshtet dhe në çerdhet e qytetit do të instalohen panele diellore që do t'u mundësojë vogëlushëve ujin e ngrohtë dhe ngrohje konstante gjatë muajve të dimrit.

# 15 MINUTA

"Hartë shkollore", çerdhe dhe kopshte funksionale sipas parimit, jo më tepër se 15 min larg.





# 3 ARTI

Zero taksë bashkiake për sipërmarrjet artistike dhe individët e pavarur që ushtrojnë aktivitete kulturore në Tiranë

# 3. ARTI

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

1. Arti dhe kultura në buxhetin e Bashkisë së Tiranës radhitet ndër vendet e fundit për përqindjen që zë në strukturën e përgjithshme të këtij buxheti, rreth 4% ose 2.5 milion euro. Referuar projektbuxhetit afatmesëm parashikohet të mbetet i pandryshuar edhe për dy vitet e ardhshme.
2. Në 8 vite të qeverisjes lokale Bashkia e Tiranës nuk ka themeluar ose ngritur asnjë institucion të ri kushtuar artit dhe kulturës, megjithëse popullsia në Tiranë është rritur me 30%.
3. Në 8 vite Bashkia Tiranë nuk ka krijuar asnjë regjistër ose bazë të dhënash mbi numrin e individëve krijues apo punonjësve të tjerë në fushën e industrisë kreative, mbi bazën e të cilave të mund të hartonte planet zhvilluese dhe investimet në sektorin e artit dhe të kulturës në Tiranë.
4. Bashkia Tiranë ishte e vetmja Bashki në Europë e cila nuk akordoi asnjë mbështetje financiare, ndihmë apo fond të veçantë, nuk parashikoi asnjë lehtësi fiskale për individët e krijimtarisë së lirë në fushën e artit dhe kulturës apo punonjësit e tjerë të industrisë kreative gjatë 2020-2021, periudhës së vështirë pandemisë COVID-19.
5. Nuk ka një agjenci ose zyrë që mbështet individët dhe organizatat në përthithjen e projekteve kulturore nga Bashkimi European.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Arti dhe kultura sot në bashkinë e Tiranës vuan mungesën e infrastrukturës. (salla teatri, ambiente multifunktionale, kinema, një bibliotekë e kryeqytetit)
- 2- Centralizimi i artit dhe kulturës në raport me demografinë dhe shtrirjen gjeografike të Bashkisë së Tiranës.
- 3- Bashkia e Tiranës ka dëshmuar një mungesë totale vizioni për ta konsideruar artin dhe kulturën si një industri që krijon të ardhura, si një industri që mund të rikthejë investimin e bërë.
- 4- Sistem fiskal vendor është tërësisht jo i favorshëm. Ky sistem ngurtëson, e mpin dhe nuk e lejon zhvillimin e një tregu të mirëfilltë të produktit kulturor dhe artistik.
- 5- Mungesa e transparencës në hartimin dhe miratimin e projekteve dhe buxhetit për artin dhe kulturën në Tiranë jo vetëm mban peng krijimtarinë artistike, por ka shkurajuar artistët më të mirë dhe të paanshëm për të aplikuar në skemat lehtësuese.

## III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJJA E SEKTORIT

Dallohet mungesa e politikave dhe vizionit të qeverisjes lokale për ta konsideruar artin dhe kulturën si një industri kreative jo vetëm me impakt social, por edhe ekonomik. Vendimarrja e centralizuar dhe vertikale, mungesa e transparencës, i ka bërë institucionet publike të artit dhe kulturës më të varura ndaj pushtetit, më hermetike ndaj individit krijues apo punonjësve të tjerë në fushën e artit e kulturës dhe si rrjedhojë më pak efikase, po kështu, produktin artistik më të fragmentarizuar dhe më pak konkurrues.

## IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJJA

- Arti dhe kultura në vizionin tonë të qeverisjes do të qëndrojnë përtej dhe mbi politikën, duke i shërbyer mirëqenies, tolerancës dhe duke kontribuar në artin e të jetuarit së bashku. Kjo e mbështetur mbi

parimet: art dhe kulturë e aksesueshme për këdo, jo vetëm si një e drejtë njerëzore, por si një faktor themeltar për një shoqëri më të shëndetshme, më tolerante dhe gjithëpërfshirëse.

- Decentralizimi dhe krijimi i poleve të kulturës duke rishpërndarë, e bazuar kjo në parime demografike, produktin kulturor drejt periferisë dhe gjithashtu në përfshirje të individit krijues në po të njëjtat zona.
- Depolitizimi i administratës në institucionet kulturore si një garanci në miradministrim dhe mirëmenaxhim drejt zhvillimit cilësor të artit, kulturës dhe integritit të produktit artistik në një treg ku konkurrueshmëria është motori që lëviz çdo mekanizëm.
- Diversitetet kulturore nuk duhet të na ndajnë nga njëri-tjetri, përkundrazi, bashkëjetesa harmonike mes kulturave, traditave, trashëgimisë, besimeve, gjuhëve është parakushti për kohezion social në vizionin tonë në drejtimin e Bashkisë së Tiranës.

## V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

**1- Rishikim të politikës fiskale të Bashkisë Tiranë** për të lehtësuar të gjithë spektrin e industrisë kreative. Arti dhe kultura duhet dhe mund të zhvillohen e shndërrohen në një industri kreative me impakt social dhe ekonomik vetëm nën një politikë fiskale më tolerante, më frymëdhënëse, duke i konsideruar si një prioritet. Zbatimi i politikave fiskale, të cilat kanë si synim fuqizimin e individit, çlirimin dhe forcimin e tregut në vizionin tonë të menaxhimit dhe drejtimit të Bashkisë së Tiranës, janë mekanizmi i duhur për të përfituar ndryshime cilësore dhe një zhvillim të qëndrueshëm në këtë sektor.

**2- Ngritja dhe themelimi i disa institucioneve të artit dhe kulturës në Tiranë:**

- Ndërtimin e objektit muzeal “Muzeu i Terrorit” dhe memorialit për viktimat e komunizmit. Transparenca dhe një raport i drejtë me të vërtetën përmes edukimit, kulturës dhe artit është një premtim i Partisë Demokratike për ndërgjegjësimin kombëtar mbi krimet e regjimit komunist.
- Ndërtimi i objektit multifunksional dhe Bibliotekës së Tiranës.
- Themelimi i Qendrës së Artit Ballkanik, në bashkëpunim me bashkitë e kryeqyteteve të Ballkanit Perëndimor.

**3- Programe prioritare**

- “RINFOND” - Program që mbështetet nga një fond i dedikuar për artistët e rinj në të gjitha fushat e krijimtarisë, për të mundësuar kalimin e tyre nga shkolla drejt tregut të punës, promovimin dhe mundësinë e punësimit si artistë të pavarur.
- “ART-BANK” - Një program inovativ që synon përmes marrëveshjeve me bankat e nivelit të dytë angazhimin e tyre filantropik në promovimin dhe marrjen në patronazh të një muzeumi, galerie apo ekspozite.
- “DuART” - Një program që parashikon të rikujtojë nënpërfaqësimin e grave dhe vajzave në fushën e artit dhe kulturës, veçanërisht në target-grupin e artistëve të pavarur për shkak të specifikave dhe vështirësive që bart vetë fusha e artit dhe kulturës; që kërkon aplikim e mekanizmave shtesë për të ruajtur një përfshirje më të drejtë të grave dhe vajzave në art dhe kulturë.
- “DuART” - Një program që parashikon të rikujtojë nënpërfaqësimin e grave dhe vajzave në fushën e artit dhe kulturës, veçanërisht në target-grupin e artistëve të pavarur, për shkak edhe të specifikave dhe vështirësive që bart vetë fusha e artit dhe kulturës, kërkon aplikim e mekanizmave shtesë për të ruajtur një përfshirje më të drejtë të grave dhe vajzave në art dhe kulturë.

# 0%

Niveli i taksimit për taksat dhe tarifatat lokale për sipërmarrjet e artit



# 4 BUJQËSIA

Çmonopolizim i tregut ushqimor. Hapjen e 5 tregjeve në pikat hyrëse të Tiranës dhe promovimi i ushqimit të “Kilometrit 0”

# 4. BUJQËSIA

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Zonat rurale të Bashkisë së Tiranës, në këto tetë vitet e fundit, kanë qenë tërësisht të neglizhuara dhe jashtë vëmendjes së qeverisjes lokale. Kjo duket në mungesën e investimeve në kanalet vaditëse, të ujitjes e kullimit, të ruajtjes së territorit etj., për pasojë, në këto vite, ka patur largime masive nga fshati, kryesisht të të rinjve, të cilët nuk i shohin më zonat rurale si mundësi për jetesë normale.
- 2- Kostoja shumë lartë e prodhimit bujqësor, për shkak të rritjes së çmimeve të imputeve bujqësore (farërave, plehrave kimike, pesticideve etj.), ka bërë që vetëm në këto katër vitet e fundit, sipërfaqja e tokës bujqësore të kultivuar në territorin e Bashkisë Tiranë të ulet me 30 %.
- 3- Çmimet shumë të larta të bazës ushqimore, si dhe mungesa e mbështetjes financiare për blegtorinë, ka bërë që në territorin e Bashkisë Tiranë në këto katër vitet e fundit, numri i krerëve të gjësë së gjallë në sektorin blegtoral të ulet me gati 50 %.
- 4- Për shkak të mungesës së tregjeve bujqësore, pamundësisë së fermerëve për të tregtuar në qytetin e Tiranës, si edhe për shkak të konkurrencës së pandershme dhe klientelizmit të favorizuar nga Bashkia e Tiranës, çdo vit rreth 25 % e prodhimit bujqësor në territorin e bashkisë, nuk shitet. Kjo ndodh gjithashtu, sepse në rang qendror dhe vendor pushteti preferon importuesit e produkteve bujqësore, jo prodhuesit vendas.
- 5- Keqmenaxhimi i territorit, ndërtime pa kriter dhe mungesa e kontrollit në territorin e Bashkisë, e cila ka përdorur Policinë Bashkiake vetëm për t'u vënë gjoba automjeteve, ka bërë që toka bujqësore të dëmtohet në mënyrë të përvitshme, dhe sipërfaqja e tokës të reduktohet nga viti në vit.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Bashkia e Tiranës shpenzon rreth 190 milionë euro në vit, nga këto vetëm 1 milion euro ose 0.6% e buxhetit të saj i drejtohet operacioneve të mirëmbajtjes së infrastrukturës bujqësore. Me këto shifra mund të kuptojmë nëpërkëmbjen me të cilën Erjon Veliaj po e trajton këtë sektor dhe mjerimin infrastrukturor që po pengon rritjen në cilësi dhe sasi të produkteve bujqësore dhe blegtorale.
- 2- Bashkia e Tiranës nuk po zbaton as edhe një skemë të sajën që lidhet me mbështetjen financiare në favor të transformimit dhe paketimit të produkteve bujqësore, duke lënë fushë të lirë importuesve të ushqimeve të huaja të cilët blejnë produkte të subvencionuara nga shtetet e tjera.
- 3- Traditat kulinare të qytetit dhe të zonave rreth tij nuk po ruhen; produktet autoktone tipike vendase dhe ato artizanalet e kanë të vështirë të mbijetojnë, pasi institucionet vendore nuk bëjnë asgjë për të favorizuar certifikimin e këtyre produkteve dhe ruajtjen e tyre për t'u tregtuar brenda dhe jashtë vendit.
- 4- Mosfunksionimi i sistemit të ujitjes së tokës bujqësore, paaftësia financiare për të përballuar shpenzimet e prodhimit kanë bërë që pjesë gjithnjë e më të mëdha të tokës bujqësore të lihen pa punuar.
- 5- Mungesa e infrastrukturës rrugore dhe mosplanifikimi e shtrirjes së rrjetit të komunikimit në zonat rurale të Bashkisë, në veçanti malësia e Tiranës, e ka bërë të kushtueshme, të vështirë dhe të lodhshme përcjelljen e produktit bujqësor në treg.

### **III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJIA E SEKTORIT**

Bashkia e Tiranës nuk ka as edhe një filozofi për sektorin e bujqësisë dhe për zonat rurale thjesht nuk i intereson! Lali Eri kujtohet të udhëtojë drejt qendrave administrative një herë në katër vjet për të kërkuar votën me hir apo me pahir. Lali Eri thotë se ka ndërtuar tregje në shumë fshatra të Tiranës, por po ata shitës ambulantë që vinin në qytet dhe shisnin produktet e tyre vijojnë të vijnë me të njëjtat produkte. Natyrshëm lind pyetja: Përse Erjoni ka ndërtuar tregjet në Baldushk apo Farkë, kur blerësit nuk janë banorët e Baldushkut por ata të Tiranës? Banalisht duhet kuptuar se tregjet e produkteve bujqësore duhet të ndërtohen në pikat hyrëse të qytetit, aty ku qytetarët mund të shkojnë lehtësisht e të mos bëjnë 30-40 km për të blerë produkte bujqësore.

### **IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJIA**

Është e domosdoshme që Bashkia e qytetit të pesëfishojë shpenzimin drejt infrastrukturës bujqësore dhe iniciativave në favor të produkteve bujqësore. Mbështetja duhet të duket me ndërtimin e tregjeve të reja në pikat e hyrjes së qytetit, që të lehtësojnë sjelljen e produkteve bujqësore nga prodhuesit dhe të mos detyrojnë qytetarët të marrin automjetet e të shpenzojnë 10-20 mijë lekë të vjetra karburant. Në të njëjtën kohë fshati do të shihet si një vlerë e shtuar që qyteti ka, duke e bërë atë pjesë të udhërrëfyesve turistik për të kuptuar pjesë të identitetit të qytetit. Tirana duhet të lidhet me rrugë cilësore me çdo qendër të saj administrative!

### **V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE**

- 1- Vendosja në funksionim të plotë i të gjithë rrjetit ujitës që shtrihet në territorin e zonave rurale të Bashkisë Tiranë dhe që është në administrim nga kjo Bashki. Përgjatë katër viteve e gjithë sipërfaqja e tokës bujqësore do të ketë mundësi ujitjeje të plotë.
- 2- Rehabilitimi progresiv i rrugëve rurale në të cilat nuk ka patur ndërhyrje në vitet e fundit, gjithsej rreth 250 km, duke garantuar daljen në treg për të gjithë familjet fermere. Ndërtimi i së paku pesë tregjeve të produkteve bujqësore në pikat hyrëse të qytetit, të cilat do të kenë vend specifik për fermerët e Malësisë së Tiranës, zonës së Kamzës, zonës së Baldushkut dhe Ibës, zonës së Arbanës dhe Selitës.
- 3- Mbështetje financiare për të gjitha iniciativat që synojnë standardizimin cilësor dhe certifikimin e produkteve vendore, paketimin e tyre dhe ngritjen e aktiviteteve industriale të lehta.

# **5 TREGJE**

Hapjen e 5 tregjeve në pikat hyrëse të Tiranës dhe promovimi i ushqimit të “Kilometrit 0”



# 5 EKONOMIA

Tri zona të lira ekonomike në zonën e Krrabës,  
Arbanës dhe Ndroqit për fuqizimin e ekonomisë së Tiranës.  
Inicim Ligj i ri i posaçëm për Tiranën

# 5. EKONOMIA

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Tirana është qendra e aktiviteteve ekonomike dhe prodhuese më të rëndësishme në të gjithë vendin. Në qytetin e Tiranës banojnë 30% e popullsisë së Shqipërisë dhe prodhohet 40% e Prodhimit të Brendshëm Bruto.
- 2- Në Tiranë janë aktive më shumë se 46 mijë biznese që veprojnë në fusha dhe dimensione të shumëllojshme, dhe nga këto rreth 6 mijë biznese janë aktivitete prodhuese. Rreth 42 mijë biznese janë ndërmarrje të vogla dhe familjare, ndërsa një mijë ndërmarrjet më të mëdha kanë më shumë se 50 të punësuar secila.
- 3- Në Tiranë ka rreth 270 mijë persona të punësuar ose 37% në raport me totalin e Shqipërisë dhe qyteti kryeson natyrisht edhe në të dhënat e depozitave bankare dhe investimeve financiare.
- 4- Duke qenë edhe qendër industriale dhe prodhuese, qyteti ka nevojë për një infrastrukturë rrugore dhe hekurudhore të rëndësishme dhe të mirëmbajtur.
- 5- Me heqjen e vizave në vitin 2010, shqiptarët filluan të udhëtonin lirshëm në Europë. Në mënyrë progresive edhe Shqipëria, e në veçanti Tirana, po bëhet qytet gjithnjë e më i vizituar për arsye të ndryshme nga turizmi të biznesi. Sot në Tiranë ka 4 mijë biznese me pronësi dhe bashkëpronësi midis qytetarëve shqiptar dhe atyre të huaj.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Bizneset e qytetit kanë probleme të mëdha për gjetjen e burimeve njerëzore të formuara dhe të përgatitura.
- 2- Kosto e lartë e energjisë dhe e karburanteve që ndikon të çmimet përfundimtare dhe që përkeqësohet nga trafiku i rënduar.
- 3- Infrastruktura në zonat industriale të qytetit është e rrënuar, siç e dëshmon situata e rrugëve dytësore në krah të autostradës Tiranë - Durrës
- 4- Gjoha të larta dhe pagesa taksash të vështira dhe problematike janë përditshmëria për bizneset
- 5- Konkurrenca e pandershme nga shitësit ambulantë dhe nga bizneset e lidhura me pushtetin.

## III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJJA E SEKTORIT

Filozofia e Erjon Veliajt është e thjeshtë: Takso e takso, shpërdoro e shpërdoro! Veliaj e ka të lehtë të bëhet i bukur e të ngopi mediat me reklamat e veta, duke i paguar ato me taksat tona. Veliaj është i kapur dhe ka kapur oligarkët ekonomik dhe politik të Shqipërisë që banojnë në Tiranë. Për Veliajn kanë rëndësi vetëm bizneset e një grupi njerëzish që zotërojnë mediat, kompanitë oligopoliste dhe ato të ndërtimit. Veliaj nuk do t'ia dijë për mbi 40 mijë biznese të vogla e të mesme të banorëve të Tiranës, të cilat krijojnë gjithnjë e më shumë vështirësi mirëqenie për veten e për të punësuarit e tyre.

## IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJJA

Tirana duhet të jetë qyteti ku gërshetohet puna dhe argëtimi, vendalinjtë e të ardhurit, shqiptarët e të huajt! Qyteti ka aftësitë dhe mundësitë për të qenë qendër financiare, qytet prodhues dhe selia qendrore e kompanive



më të mëdha të shërbimeve në rajon. Bashkia nuk duhet të harrojë kurrë se në Tiranë ka mbi 40 mijë biznese të vogla e të mesme të cilat nuk duhet të rrënohen nga gjobat dhe konkurrenca e pandershme. Këto biznese kanë nevojë për t'u mbrojtur e për t'u ndihmuar që të rriten e të zhvillohen për të krijuar më shumë pasuri dhe vende pune. Në të njëjtën kohë, Bashkia duhet të inkurajojë e promovojë shpirtin e iniciativës, filizat e reja, tentativat dhe ëndrrat që rinia e qytetit ka për një ekonomi më të përparuar e që lidhet me bizneset e reja, në fushën e IT, të ekonomisë qarkulluese e të blertë, të modës, artit dhe të teknologjisë smart!

## V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

- 1- Përtej heqjes së taksës së infrastrukturës arsimore dhe përgjysmimit të taksës për pastrimin për bizneset, Bashkia do të krijojë lehtësira fiskale dhe do të promovojë financiarisht të gjitha masat që do të merren nga bizneset që synojnë prodhimin dhe kursimin e energjisë (panelet diellore, instalime cilësore në godina, përdorimi i mjeteve hibride dhe elektrike etj...) dhe të gjitha format e smart working.
- 2- Bashkia do të jetë në dispozicion për të trajnuar falas të punësuarit që merren me pagesat e taksave vendore të çdo biznesi, në mënyrë të tillë që midis biznesit dhe administratës vendore të krijohej një partneritet miqësor dhe i sigurtë, në mënyrë të tillë që gjobat mos të jenë normalitet për bizneset por raste përjashtimore.
- 3- Në Tiranë do të ngrihen dhe funksionojnë së paku 4 tregje të reja publike, në të cilat do të promovohen produktet vendore tipike, të shëndetshme dhe të sigurtat. Biznesi i vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike. Bashkia do të ofrojë grante financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm që veprojnë në fushat klasike dhe në ato inovative sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

# 3 ZONA TË LIRA EKONOMIKE

Tri zona të lira ekonomike në zonën e Krrabës,  
Arbanës dhe Ndroqit për fuqizimin e ekonomisë së Tiranës.  
Inicim Ligj i ri i posaçëm për Tiranën.



# 6 KUJTESA

Shpallja muze e “Burgut 313”, vend i vuajtjes së dënimit. Vila 31 e Enver Hoxhës, qendër e edukimit dhe informimit për kujtesën e komunizmit



# 6. KUJTESA

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Peizazhi urban në Tiranë duhet të përfaqësojë kujtesën publike të qytetarëve të Tiranës. Por kjo memorie, shpesh, bie preh e vendimarrjes së pushtetit, që imponon botëkuptimin e vet në shfrytëzimin e këtij peizazhi, ku mbi të shkuarën komuniste Bashkia aktuale e Tiranës nuk ka patur vëmendjen për t'iu përkushtuar.
- 2- Peizazhi memorialistik publik në Tiranë ka lënë në hije kërkesat e shumta që grupet e të përndjekurve politikë gjatë komunizmit drejtojnë për ngritje të memorialit për viktimat e komunizmit në Shqipëri, të një muzeu të krimeve të diktaturës, të diktuar edhe nga Ligji “Për simbolet e përkujtimit të viktimave të komunizmit në Shqipëri” (Nr. 10 241/2010), i cili ka mbetur vetëm në letër, pa u realizuar asnjë pikë e parashikuar prej tij mbi ngritjen e një muzeu, obelisk apo monumenti në përkujtim të viktimave të komunizmit në Tiranë.
- 3- Tek-tuk, forma sporadike të memorializimit të kujtesës mbi komunizmin u janë lënë në dorë iniciativave private të promovohen, si BunkArt 1-2, dhe viktimave të komunizmit u është lënë vetëm një pavion në Muzeun Historik. Ndërsa Muzeu Kombëtar “Shtëpia me gjethë” është ngritur si një muze për të treguar rrjetin e spiunazhit të Sigurimit të Shtetit.
- 4- Rrugët e kryeqytetit ende mbartin emra kontroversiale ndaj viktimave të komunizmit.
- 5- Në sheshet publike të Tiranës, në rastet e përkujtimit të ngjarjeve që lidhen me të kaluarën komuniste, shfaqen fotografi të diktatorit dhe anëtarëve të ish-Byrosë Politike të PPSH nga grupe nostalgjikësh.

## III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJA E SEKTORIT

Në kuadër të iniciativës së Partisë Demokratike për ballafaqim me të kaluarën komuniste do të rivlerësohet përdorimi i hapësirës publike të kryeqytetit për të mos lejuar që kjo hapësirë të bëhet shesh i shfaqjes së simbolikave të diktaturës, përmes shfaqjes dhe përdorimit të saj nga grupe nostalgjikësh të komunizmit, të cilët fyejnë dhe lëndojnë kujtimin e viktimave të komunizmit.

## IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJA

Futja e Tiranës në hartën e qyteteve të Evropës Lindore që kanë kryer me sukses dekomunizmin e hapësirave urbane të tyre, duke stimuluar dhe turizmin kulturor mbi diktaturën në hapësirën e kryeqytetit.

## V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

- 1- Rivlerësim i të gjitha emrave të rrugëve dhe shkollave të kryeqytetit në bashkëpunim me grupet e interesit dhe shoqërinë civile, duke vlerësuar emërtimet e tyre me qëllim shkëputjen e simbolikave me të rënda të së kaluarës komuniste, në formën e memorialëve, pllakave përkujtimore të shpërndara në të gjithë territorin e Tiranës.
- 2- Memorializimi i kujtesës mbi krimet e komunizmit dhe vuajtjeve në burgjet e komunizmit, vendet e internimit, përmes ngritjes së Muzeut të Krimeve të Komunizmit në Tiranë. Ish-godina e burgut 313, e ndërtuar nga italianët më 1942 ngjitur sot më Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, gjatë diktaturës komuniste ka shërbuer si vend paraburgimi dhe përqëndrimi të të burgosurve (kaush) që vinin kryesisht nga kampet dhe burgjet e Shqipërisë.
- 3- Ngritja e një Parku të tipit “open air museum” në Tiranë (mbase diku tek Bulevardi i Ri) për personat e zhdukur/vrarë në burgjet e komunizmit.
- 4- Insistimi për kthimin e “vilës së Enverit” në një qendër kreative për edukimin kundër komunizmit në Shqipëri dhe vendosja në oborrin e vilës të një memoriali/munument/obelisk sipas Ligjit Nr. 10 241/2010.
- 5- Krijimi i një aplikacioni Guidë e vendeve të kujtesës në Tiranë.
- 6- Përgatje projektligji për shtresën e ish-të përndjekurve politikë për banesat publike dhe shërbimet shëndetësore.

# 2 MUZE

Shpallja muze e “Burgut 313” vend i vuajtjes së dënimit. Vila 31 e Enver Hoxhës, qendër e edukimit dhe informimit për kujtesën e komunizmit.



# 7 MJEDISI

Afrimi me normat europiane mjedisore mbi ndotjen ajrit dhe ujit, deri në fund të mandatit

# 7. MJEDISI

## I. TË DHËNA SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

1. Vlera e treguesit të sipërfaqeve të gjelbra në BE është shumë e variueshme nga një qendër e banuar tek tjetra. Konsiderohen si të mjaftueshme vlerat 10-30 m<sup>2</sup> për një banor dhe shumica e qyteteve kryesore europiane mbajnë këto vlera. Konsiderohen me mungesa në plotësimin e standarteve mjedisore, ato qendra të banuara që këtë tregues e kanë më poshte se 5 m<sup>2</sup> / banor. Tirana jonë nuk ka të dhëna të besueshme për vlerën e këtij treguesi, por ekspertët e mjedisit thonë se ky tregues është shumë i ulët, nuk kalon 1 m<sup>2</sup>/banor.
2. Disa norma të BE për hapësirat publike në (m<sup>2</sup>/banor):
  - Sipërfaqe e gjelbër publike = 9;
  - Sipërfaqe ambjenteve të shkollimit publik = 4.5;
  - Sipërfaqe parkimi = 2.5;
  - Sipërfaqe shërbimi komunitar = 2.

Tirana ka 0.8 m<sup>2</sup> sipërfaqe të gjelbër për person

## II. PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

1. Dendësia e lartë e ndërtimeve ka perkeqësuar situatën mjedisore në qytetin e Tiranës, por ndërtimet pa kriter dhe pa plan urbanistik po bëhen fenomen shqetësues për mjedisin edhe në zonat rurale;
2. Sistemi i grumbullimit, trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve është akoma shumë larg kërkesave të kohës dhe standarteve të BE;
3. Raporti mes sipërfaqeve të gjelbra dhe atyre të betonizuara është në favor të betonit dhe shumë larg normave të BE;
4. Tirana nuk ka një impiant bashkëkohor të trajtimit të mbetjeve dhe të pastrimit të ujërave të zeza;
5. Tirana nuk ka ujë të pijshëm 24-orë. Uji që përdoret sot nga banoret e Tiranës është ujë depozitash dhe, në të shumtën e rasteve, i ndotur aq sa nuk mund të përdoret për larje.

### III. KRITIKA PER ÇFARE ËSHTË BËRË DERI TANI DHE ALTERNATIVA JONË

1. Ndërtimet pa kriter dhe me prapavijë korruptive i kanë zënë frymën Tiranës. Në këto kushte, cilësia e jetës së banorëve të saj është e një niveli shumë të ulët. Përtej propagandës së kryetarit aktual, qytetarët e Tiranës jetojnë nën stresin e trafikut dhe të ndotjes së ajrit.
2. Sipërfaqet e gjelbra nuk maten me numër bimësh të mbjella. E vetmja anë pozitive ka qenë mbjellja e bimëve ornamentale në anët e rrugëve. Ato krijojnë mjedis komod për këmbësorët. Edhe këtu ka vend për përmirësime, pasi ka lloje bimësh që prodhojnë masë të madhe poleni duke shkaktuar alergji tek njerëzit.
3. Zgjidhje për situatën e krijuar është shumë veshtirë të gjenden, por marrja e këtyre masave do të lehtësonin sadopak problemin:
  - Ndërtimi i një sistemi të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve;
  - Riciklimi i mbetjeve të riciklueshme;
  - Sistemimi dhe përmirësimi i landfildit ekzistues;
  - Ndërtimi i një apo disa impianteve të pastrimit të ujërave të zeza;
  - Ndërtimi i tri parqeve të gjelbra: në Kashar, në Paskuqan dhe në Mullet;
  - Lejet e ndërtimit duhet të kushtëzohen me krijimin e sipërfaqeve të gjelbra.
  - Prodhimi i energjisë me panele diellore. Tirana ka rreth 280 ditë me diell në vit dhe kjo mund të shfrytëzohet. Pse të mos kenë të gjitha tarracat e pallateve panele diellore? BE investon shumë në këtë fushë. Prandaj aplikimi i Bashkisë në projekte të BE do të siguronte një pjesë të mirë të financimit për realizimin e projekteve të tilla.
  - Jo vetëm “24 orë ujë”, por ujë i pijshëm në çezmat tona. Të fillojë identifikimi i burimeve ujore brenda dhe jashtë territorit të Bashkisë dhe të hartohen projekte për sjelljen e ujit të pijshëm në Tiranë.

**350**  
**MIKRO**  
**GRIMCA m<sup>3</sup>**

Afrimi me normat europiane mjedisore mbi ndotjen ajrit dhe ujit, deri në fund të mandatit.



# 8 STREHIMI

Mundësi strehimi për të gjithë. Luftë çmimeve të larta të banesave. Ulje e taksës lokale nga 12% në 5 % ndaj ndërtuesve. Trasparençë financiare për ndërtimet në Tiranë



# 8. STREHIMI

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

### 1- Stoku i banesave dhe mungesa e banorëve për t'i banuar.

Popullsia e Tiranës, sipas INSTAT ka arritur në vitin 2022 në rreth 850 mijë banorë. Kryeqyteti regjistron një rritje prej 76 530 banorësh në 6 vjet, por ajo që nuk evidentohet është rënia e ritmit të rritjes së popullsisë. Për rritjen e popullsisë Tirana do të duhej të kishte zhvilluar 1/3 e volumit, duke marrë parasysh se stoku i banesave ka qenë gjithmonë i pranishëm në sektor. Ndërsa sektori nga 2016 ka rritje rreth 7 milionë metra katror ndërtim ose 70 mijë apartamente për 280 mijë banorë. Çfarë mungon ka herë është transparenca në lidhje me volumin e banesave të regjistruara, por të pabanuara.

### 2- Konfiskimi i pallateve pa leje nuk i shërben strehimit social

Vendimet e fundit të qeverisë në vitin 2022, për konfiskimin e volumeve pa leje në objektet me leje ndërtimi, mund të themi se kanë prodhuar një formë të re të informalitetit. Deri më sot jemi përballur me faktin e kryer nga ana e banorit, një formë informale sa edhe demokratike, pasi u zhvillua pa ndihmën dhe rregullimin e institucioneve. Ndërtimi informal ka qenë i zhvilluar dhe institucioneve u është dashur të zgjidhin pasojat e këtij modeli zhvillimi. Ky rast na sjell një formë të re, kur ndërtimi është ende në proces dhe ndërhyrja ad hoc nga ana e institucioneve nuk dihet se çfarë pasoje do të prodhojë.

### 3- Miliona metra katror beton për shitje, asnjë metër katror për strehim social

Referuar nenit 38 të ligjit “Për strehimin social” pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25% të të ardhurave të familjes. Ndërkohë, qiratë në Tiranë në zonat periferike fillojnë nga 30.000 lek, ndërsa në qendër kushtojnë më shumë se dyfishi i shumës prej 18.000 lekësh që ata përfitojnë nga bonuset e dhëna nga Bashkia. Deri në vitin 2022, janë rreth 1708 familje me status të pastrehë si pasojë e ndërhyrjeve në dy zona të shpallura për rindërtim, Kombinat dhe 5 Maji, duke rritur numrin e të pastrehëve artificialisht. Ndërkohë, në katër vitet e fundit (2018- 2022) vetëm 28% e 11,603 familje që kanë aplikuar për strehim social e kanë përfituar atë. Raportet tregojnë se vetëm 12% e aplikuesve kanë arritur të marrin strehim social në Tiranë.

### 4- Planet e detyruara si justifikim për mungesën e planit të emergjencave

Bashkia e Tiranës i ka trajtuar ndërhyrjet urbane të tipit Kombinat dhe 5 Maji në dy standarde. Një herë i trajton si plane emergjencash nga tërmeti dhe një herë si plane pjesë e planeve vendore.

Së dyti, le të kalojmë në atë që bashkia e quan pjesë të rregullimit të territorit. Në këtë rast këto “rregullime” nuk do të duhet të kalojnë sipërfaqen prej 5 hektarë. Teknikisht në sot kemi të bëjmë me një zonë e cila është duke u transformuar për 20-30 hektarë. Dhe kjo është sikur të shqepësh të gjithë qytetin njëherësh. Në planet e detajuara vendore specifikohet se ndërhyrjet ndodhin në shkallë të vogël, në qelizë, lagje, komunitete dhe me shkallën e dimensionit ku mund të ndodhë dakordësimi me banorët.

### 5- Përrjashtimi i banorit dhe urbicidi si fenomen i stimuluar me plan

Kemi sot projekte që reklamohen si një nevojë ekonomike por jo si nevojë urbane. Pra, realizimi i unazave dhe poleve periferike në Tiranën e ditëve të sotme nuk vjen si një nevojë e zhvillimit ekonomik të qytetit, por si një nevojë e përforsimit të tregut imobiliar në qytet.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

1. Qyteti ka zhvilluar miliona metra katror ndërtim për strehë, dhe në mënyrë proporcionale ka shtuar numrin e të pastrehëve të rinj të qytetit
2. Planet e strehimit, si pasojë e emergjencës për strehë nga tërmeti, janë shndërruar në plane përfitimi duke shfrytëzuar emergjencat

3. Ligji për strehimin social nuk gjen zbatim në bashkinë e Tiranës, 3% i sipërfaqes së destinuar për strehim social, nuk ka kaluar në stokun e banesave.
4. Nevoja për strehim është në rritje jo vetëm për kategoritë e pa favorizuara, por edhe për shtresat e mesme të shoqërisë
5. Aktualisht, ligji nr. 22/2018 për Strehimin Social nuk po zbatohet në mënyrën e duhur dhe procedurat e zhvendosjes së qytetarëve vazhdojnë të jenë abuzive.

### III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJIA E SEKTORIT

Strehimi është e drejtë njerëzore dhe si i tillë është detyrim kushtetues që merret në konsideratë në planet e zhvillimit urban. Bashkia e Tiranës ka detyrimin që të bëjë planet sociale dhe t'u japë banesë personave të dalë të pastrehë nga çdo projekt i cili ndërtohet në qytetin e Tiranës. Ky detyrim kushtetues nuk është realizuar nga Bashkia Tiranë. Banorët e shpronësuar, dhe ata të shpërngulur, janë njerëz që shkojnë drejt grupeve vulnerabel të qytetit, sepse janë të pastrehë. Sot janë me mijëra familje të shpallura 'të pastreha' që duhet të aplikojnë një nga programet e strehimit social në bashki, duke rritur artificialisht këtë kategori.

### IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJIA

Institucionet publike në këto raste bëjnë udhëzimin dhe reduktimin dhe paqeruajtësin dhe njëkohësisht garantimin e të drejtave themelore. Pra si përkthehet kjo gjë teknikisht, përkthehet në rrjet urbanizimi, përkthehet në ndarje parcelash, përkthehet në shërbime jo të ndërtuara, por ama të adresuara. Në momentin kur kemi të bëjmë me një administratë publike, e cila ka të qartë mënyrën e zhvillimit, atëherë zhvillimi ndodh kryesisht në një treg të lirë dhe duhet të ndodhi nga privati.

### V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

Bashkia duhet të ripozicionohet duke lënë tregun, kërkesën dhe ofertën të zhvillohet natyralisht. Në gati 25 vite tranzicion të strehës, mbas viteve '90 afërsisht 70% e popullsisë nuk kishin një strehë. Tashmë jemi në një situatë ku dikush para 15 viteve ka pasur mundësinë që të binte në dakordësim me investimin dhe me zhvillimin e qytetit të siguronte një strehë. Ndërsa sot asnjë banor nuk ka të drejtën që të bjerë në dakordësi me tregun, duke qenë se bashkia është futur si palë e ndërmjetme duke influencuar dhe spekuluar me tregun. Ligji për strehimin social, bashkë me aktet nënligjore të tij, duhet vënë në zbatim, në mënyrë proporcionale pa dallime krahinore, racore apo politike. Ligji për strehimin social ka një qasje më proaktive krahasuar me të vjetrin, tashmë të varfrit do duhet të kishin nisur të përfitonin nga ligji dhe jo të lihen në qiell të hapur aq më pak të ngarkohen në kurriz të taksapaguesve të tjerë, siç po ndodh me bonuset e qirave. Instrumentet për strehimin e përshtatshëm janë, stoqet e banesave janë tashmë në territor, mungon vullneti politik për t'i strehuar. Bashkia duhet të marrë iniciativën të zhvillojë planin e emergjencave që t'i bashkëlidhet planit të përgjithshëm vendor, për rastet e fatkeqësive që vijnë si pasojë e fenomeneve natyrore të cilat do të vijnë duke u shtuar në të ardhmen si pasojë edhe e ngrohjes globale, si edhe për faktin që Tirana gjendet në zonë sizmike aktive. Planet e evakuimit, të strehimit dhe ato të ndihmës së parë, do të duhen të jenë prioritet për bashkinë në dekadën që kemi hyrë.

# 5% TAKSA

Mundësi strehimi për të gjithë. Luftë çmimeve të larta të banesave. Ulje e taksës lokale nga 12% në 5 % ndaj ndërtuesve. Transparencë financiare për ndërtimet në Tiranë.



# 9 SHËNDETI PUBLIK

Infrastruktura dhe kujdes shëndetësor  
jo më larg se 15 minuta

## 9. SHËNDETI PUBLIK

### I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Tirana ndër qytetet më të ndotur të Europës (Numbeo index)
- 2- PM 2.5 gjendja: 104  $\mu/m^3$  vs standardit 25  $\mu/m^3$  ("Mushkëri të gjelbra" v.2021, nga Co-Plan)
- 3- PM10 gjendja: 420  $\mu/m^3$  vs standardi 60  $\mu/m^3$  ("Mushkëri të gjelbra" v.2021, nga Co-Plan)
- 4- Cilësia dhe aksesit ndaj ujit të pijshëm: 26.83 (low) Numbeo index,
- 5- Cilësia e jetës në Tiranë: Numbeo quality of life index 90.07 very low

### II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Kontrolli i ulët ndaj ndotësve të ajrit ( ndërtues, prodhues
- 2- Mungesa e pastrimit dhe larjes së rrugëve
- 3- Mungesa në investime në rrjetin ujqor dhe mungesa e ujit në rrjet 24 orë
- 4- Mungesa e hapësirave të gjelbra
- 5- Mungesa e kryqëzimeve që mundësojnë lëvizjen e trafikut, si rrjedhojë uljen e ndotjes së ajrit

### III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJJA E SEKTORIT

Aktualisht, Bashkia Tiranë thuhet nuk i jep vetes rol në shëndetin publik.

### IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJJA

Tirana qytet i shëndetshëm: Ajër i pastër, ambiente të gjelbra dhe ujë i pijshëm i sigurt.

### V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

- 1- Pastrimin e qytetit nga pluhuri me anë të shtimit të sipërfaqeve të gjelbra, kontrolli i ndotësve të ajrit (kantieret e ndërtimit, larja e rrugëve, mbushja e gropave)
- 2- Përmirësimi i transportit publik (flotë e re autobusësh ekologjikë) dhe lehtësi për taksitë elektrike dhe hibride
- 3- Përmirësimi i trafikut urban nëpërmjet një plani të përgjithshëm urban të shoqëruar me kryqëzime që lehtësojnë trafikun

# 15 MINUTA

Infrastruktura dhe kujdes shëndetësor jo më larg se 15 minuta.



**TAXES**

# **10 TAKSAT**

Taksa të ulëta, taksa për të gjithë. Përgjysmimi 50% i taksave aktuale. Eliminimi i gjysmës së tarifave, luftë informalitetit

# 10. TAKSAT

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Bashkia e Tiranës ka një buxhet të përgjithshëm prej rreth 23 miliardë lekësh të reja, por më pak se 15 miliardë lekë vijnë nga të ardhurat e saj, pjesa tjetër janë transfera nga Qeveria.
- 2- Bashkia e Tiranës shpenzon 6.5 miliardë lekë ose rreth 60 milionë euro për të paguar mbi 8 mijë të punësuar, duke mbajtur një administratë tepër të madhe që peshon mbi xhepat e qytetarëve.
- 3- Bashkia e Tiranës mbledh çdo vit 4.8 miliardë lekë ose 42 milionë euro taksë nga ndërtimi i pallateve të reja. Kjo do të thotë se më shumë se 30% e të ardhurave të saj vijnë nga lejet e ndërtimit.
- 4- Bashkia e Tiranës arkëton çdo vit 5.5 milionë euro në gjoba dhe penalitete që vendosin 600 policë bashkiak dhe po aq para mbledh nga parkimet që ajo menaxhon.
- 5- Janë rreth 7 milionë euro që Bashkia mbledh çdo vit nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore, e cila paguhet nga qytetarët dhe bizneset prej 7 vitesh dhe qytetarët që kanë biznes e paguajnë atë 2 herë.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Tirana ka sot një buxhet që varet nga sasi të mëdha lelesh ndërtimi. Me këtë shpejtësi do të duhet që për 10 vjet në qytet të ndërtohen 150 mijë apartamente shtesë. Kjo tregon se Tiranës nga një anë po i merret fryma, pasi ndërtimet e reja nuk shërbejnë nga rrugë të reja, parqe të reja, shkolla, kopshte etj., dhe nga ana tjetër, Bashkia duhet të gjej të ardhura të tjera më të qëndrueshme dhe afatgjata, ndryshe nga lejet e ndërtimit.
- 2- Qytetarët e Tiranës nuk ndryshojnë në raport me ata të Prishtinës ose Shkupit, por në rastin tonë Bashkia nuk ndërton rrugë të reja për biçikletat ose korsi shtesë për autobusat, ajo në të kundërt ngushton rrugët ekzistuese, sidomos për shoferët e makinave. Për këtë arsye të ardhurat e majme që Bashkia merr nga gjobat tregojnë se ajo nuk ka leverdi të reduktojë trafikun, por është e interesuar që qytetarët të jenë të detyruar të shkelin rregullat e qarkullimit dhe të parkimit e si pasojë t'i gjobisë për këtë, në mënyrë tinëzore.
- 3- Në Tiranë nuk ka asgjë më Definitive se e Përkohshmeja. Kjo vlen sidomos për taksat. Erjon Veliaj aprovoi në vitin 2015 taksën për ndërtimin e shkollave të reja me një afat 7 vjeçar dhe fshehurazi e shtyu dhe për 3 vite të tjera. Në këto vite ai ka arkëtuar mbi 35 milionë euro dhe kërkon të përfitojë dhe 50 milionë euro të tjera për të ndërtuar 17 shkolla, mesatarisht 3000 m<sup>2</sup> secila. Në Itali një Shkollë moderne kushton 3 milionë euro dhe Bashkia do kishte pasur mundësinë që këto shkolla t'i ndërtonte me rreth 50 milionë euro (në Itali), por Erjoni do 85 milionë euro (në Shqipëri).
- 4- Administrata e Bashkisë Tiranë ka mbi 8 mijë të punësuar midis administratës së saj qendrore dhe ndërmarrjeve ku ajo është aksionere. Kjo administratë është e stërfryrë. Për këto persona jepen paga dhe paguhen sigurime shoqërore për rreth 60 milionë euro në vit. Këto para merren nga taksat dhe tarifatat e bizneseve dhe qytetarëve të që janë të shtypur nga një administratë militantësh, të cilët janë hera-herës të paafte, të pamotivuar ose të korruptuar. Ekonomia e qytetit është e brishtë, qytetarët nuk mund të pranojnë një barrë kaq të lartë për kaq pak shërbime.
- 5- Bashkia e Veliajt merr nga qytetarët taksat mbi banesat dhe dyqanet në pronësi, merr taksa mbi tokën bujqësore, takson truallin, takson për të ndërtuar shkolla të reja, kërkon tarifë për pastrimin etj. Nga bizneset pretendon taksa mbi ndërtesën, taksat për fjetjet në hotel, taksa për reklamat dhe tabelat, taksa për tokën bujqësore, serish për infrastrukturën arsimore, pa harruar faturat e ujit të pijshëm që në fakt

është i papijshëm dhe rrjedh vetëm 1 orë në ditë, pa harruar taksat edhe mbi OJF-të, e gjobat e majme për çdo vogëlsi. Por, si përdoren këto para të vjela me hir e me pahir? Mungesa e llogaridhënies dhe errërsira e krijuar për shpërdorimin e parave të qytetarëve bën që natyrshëm të lindi pyetja. Çfarë bëhet me taksat tona?

### III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJIA E SEKTORIT

Filozofia e Erjon Veliajt është e thjeshtë: Takso e takso, shpërdoro e shpërdoro! Veliaj e ka të lehtë të bëhet i bukur e të ngopi mediat me reklamat e veta duke i paguar ato me taksat tona! Për Veliajn qyteti ekziston në funksionin e tij, që ai ta vjeli. Banorët e Tiranës për të janë injorantë të cilët duhen mësuar me parimet e rregullat që ai vendos pa përfillur fare vullnetin e qytetarëve. Tirana duhet të marrë formën që do Veliaj dhe Rama. Kjo do të thotë, më pak parqe e hapësira publike por më shumë kulla e taksa. Njerëzit duhet të jetojnë sipas udhëzimeve, të zbatojnë rregullat e të paguajnë taksat e gjobat që do Rama me Veliajn, por kjo nuk është Demokraci.

### IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJIA

Në Demokraci njerëzit nuk ekzistojnë për t'u bërë temena qeveritarëve, por këta të fundit zgjidhen nga njerëzit për t'u shërbyer atyre, jo vetes. I njëjti parim vlen edhe për taksat dhe tarifën. Bashkia pa taksa nuk mbahet, por ajo duhet t'u japi llogari qytetarëve për çdo qindarkë që shpenzon e për çdo vendim që merr në emër të banorëve të Tiranës. Çdo taksë apo tarifë para se të ndryshohet duhet të konsultohet me qytetarët e Tiranës, me grupet e interesit dhe me bizneset. Kryetari i Bashkisë është Kryeshërbëtori i qytetit, jo Kryeabuzuesi i tij. Shumica e popullsisë paguan taksa e tarifa të larta, por një pjesë e saj i bën bisht detyrimeve e ndihmuar nga një Bashki që mbyll sytë. Tani boll më! Të paguajmë me pak taksa, por t'i paguajmë të gjithë! Një Tiranë ku të gjithë japin kontributin e tyre është një qytet ku fjala komunitet merr domethënie e ku të gjithë do të ndihemi pjesë e diçkaje më të madhe e më të drejtë.

### V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

1. Tarifën e parkimit në parkingjet e bashkisë për një automjet janë 10 euro në ditë. Në Luksemburg, shteti më i pasur i Europës, ato janë 2 euro në ditë. Bashkia do të ndërtojë më shumë parkingje nëntokësore dhe në sipërfaqe, duke reduktuar deri në 80% çmimin për parkimin e automjeteve të qytetarëve dhe bizneseve.
2. Bashkia e Tiranës mbledh çdo vit mbi 20 milionë euro nga Tarifa e Pastrimit dhe gjysma e tyre shkojnë për të paguar inceneratorin e Tiranës që nuk ekziston. Përtej çështjes penale, qytetarët dhe bizneset nuk kanë pse të paguajnë më tej korrupsionin. Tarifa e pastrimit për qytetarët dhe biznese do të përgjysmohet në mënyrë urgjente.
3. Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore nuk ka arsye të ekzistojë, pasi Bashkia nuk po i ndërton shkollat e Tiranës me këto të ardhura, por i ka lënë ato që të ndërtohen me paratë e privateve me anë të kontratave PPP. Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore do të hiqet.

# -50% TAKSA

Taksa të ulëta, taksa për të gjithë. Përgjysmimi 50% i taksave aktuale. Eliminimi i gjysmës së tarifave, luftë informalitetit.



# 11

## TURIZMI

Turizëm gjatë gjithë vitit dhe i shumëllojshëm. Pesë vite zero taksë ndaj sipërmarrjeve turistike, bujtinave, start-up, etj.



# 11. TURIZMI

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Kapacitete akomoduese rreth 10.000 shtretër.
- 2- Rreth 4,5 milionë udhëtarë në Tiranë për vitin 2022
- 3- Hotele rreth 340, Subjekte akomodimi rreth 1100
- 4- Rreth 2000 shtretër janë ose hapen deri në fund të vitit hotele me 5 yje.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Dhënia e statusit Investitor Strategjik për rreth 2000 shtretër hotelesh me 5 yje duke përfituar 6% Tvsh në të gjithë shërbimet dhe shmangur taksa e tatime duke konkurruar padrejtësisht në treg.
- 2- Transporti publik nuk ka rregullsi, orare, hartë dhe identifikim të stacioneve.
- 3- Mungon një aplikacioni për informacionin e transporteve publike në Tiranë
- 4- Formalizim i tregut. Ap e vila shesin on line dhe nuk paguajnë taksa dhe janë jashtë kontrolleve për standarde
- 5- Parking për autobusat turistik apo linje, për vizitorët që vijnë në Tiranë.

## III– KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJA E SEKTORIT

Bashkia bën vetëm marrëdhënie publike për turizmin.

## IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJA

Menaxhim më i mirë i Destinacioneve Turistike

## V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

**Angazhohemi të zgjasim sezonin turistik, përmes diversifikimit të produktit turistik, në 3 tipologji: turizëm bregdetar, malor, rural e kulturor;**

- 1- Suvencionimi i biznesit të vogël të artizanatit që po shkon drejt zhdukjes.
- 2- Përmirësimi i transportit publik, në të gjithë hartën e Tiranës
- 3- Potencimi i një fshati simbol të Tiranës, për ta kthyer në origjinë.

# 0 TAKSË

Turizëm gjatë gjithë vitit dhe i shumëllojshëm. Pesë vite zero takse ndaj sipërmarrjeve turistike, bujtinave, start-up, etj.



# 12 TRANSPORTI

e-transport. Biletë unike elektronike. Formatimi i stacioneve të kronometruara urbane. Pesë parkime të mëdha publike në hyrje të Tiranës

# 12. TRANSPORTI

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Tirana ka sot 16 linja autobusash urban dhe lidhje me çdo qendër administrative të saj.
- 2- Ato që duhet të ishin portat hyrëse të transportit publik midis autobusave interurban dhe atyre urban janë ende në ndërtim (mbikalimi i Kamzës dhe TEG), e nuk dihet se kur do të përfundojnë.
- 3- Ndonëse në ndërtim, hekurudha Durrës-Rinas-Tiranë nuk dihet se si dhe kur 1 milion qytetarët e kryeqytetit do ta përdorin atë.
- 4- Asnjë plan ose vullnet nuk ka sot në qytet për të ndërtuar linja metropolitane nëntokësore apo tramvaje. Ndërkohë që në kryeqytete të tjera të rajonit si Athina, Sofja dhe Beogradi metropolitane janë në ndërtim ose realitet prej vitesh. Në Sarajeve, Zagreb dhe Shkup janë me dhjetra linjat e tramvajes.
- 5- Unaza e madhe e Tiranës po ndërtohet me shpejtësinë e breshkës dhe nëse nuk do të ketë vonesa të mëtejshme ajo nuk do të jetë gati përpara vitit 2026, vit kur do të jete bërë një tjetër unazë e brendshme e qytetit e rrethuar nga pallate e ndërtime të reja e jo me një arterie me shpejtësi të lartë.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Trafiku në oraret e fillimit dhe përfundimit të punës dhe të shkollave në Tiranë është shumë i rënduar dhe për të lëvizur nga jugu në veri ose nga lindja në perëndim të qytetit duhen 60 deri në 90 minuta, aq sa për të shkuar nga Tirana në Fier ose në Shkodër. Në Tiranë janë rreth 170 mijë mjete ose një makinë për pesë persona, ndërkohë që në Athinë ose Romë ka një makinë çdo dy ose tre persona. Në Tiranë nuk ka kaq shumë makina, por ka pak rrugë e shumë pallate!
- 2- Në dy stacionet e mëdha interurbane në Teg dhe mbikalimin e Kamzës nuk janë të përfshira as ne plan parkime të mëdha shumëkatëshe, ku qytetarët që vijnë nga qytetet e tjera (mesatarisht 30 mijë automjete në ditë) të kenë mundësinë t'i parkojnë ato dhe të vijojnë drejtë qytetit me mjete publike.
- 3- Autobusat në Tiranë ecin mesatarisht me 11 km në orë dhe kjo shpejtësi është duke rënë nga viti në vit. Kjo tregon se qytetarët e Tiranës nuk e ndiejnë transportin publik si një alternativë.
- 4- E quajnë më të vlefshme dhe vendosin të marrin automjetet e tyre ose taksi sapo krijojnë një mundësi ekonomike minimale. Në momentin kur shpejtësia e autobuzit do të arrijë në 9 km në orë për qytetarët do të jetë krejtësisht indiferente ecja në këmbë që kushton 0 lek në raport me autobusin.
- 5- Niveli i ndotjes së ajrit në Tiranë është ndjeshëm mbi normat ligjore të lejueshme të ndotjes që ka Bashkimi Europian. Në qytet mesatarisht ka 770 mikrogrimca ndotëse për m<sup>2</sup> në raport me 350 që është norma e BE-së ndërkohë që pjesa perëndimore e qytetit është ajo më e dëmshme për mushkëritë e qytetarëve.
- 6- Korsitë e biçikletave janë të mirëpritura, por ende të papërdorura mjaftueshëm, pasi në Tiranë të pakta janë vendparkimet e biçikletave, pikat e shitjes dhe të riparimit dhe rrjeti është i kufizuar në lagjet qendrore të qytetit, duke mos u bërë pjesë në lëvizjet e mëdha të popullsisë gjatë ditës nga zonat periferike drejt qendrës dhe anasjelltas.

## III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJIA E SEKTORIT

Në Tiranë janë bërë mjaftueshëm projekte dhe studime, të cilat kanë evidentuar problematikat e qytetit nga pikëpamja e lëvizshmërisë dhe kanë propozuar gjithashtu zgjidhjet prioritare e detyruese me kostot përkatëse, po filozofia e Erjon Veliajt nuk lidhet me zgjidhjen e problemeve, por me reklamizimin e figurës së tij, pasi ai

reklamizon korsi biçikletash dhe i ndërton ato pa parë flukset e lëvizjes së qytetarëve në drejtimet e tyre dhe mburret me autobusët, thjesht, sepse i ngjyros me jeshile duke thënë që janë me teknologji të pastër. Realiteti i shkatërrimit të transportit publik dhe i aksidenteve të shaktuara tregojnë se Erjon Veliaj çdo veprim e ka për t'i bërë reklamë vetes dhe nuk ka interesin më minimal as për të zgjidhur dhe as për të dëgjuar problemet e qytetarëve dhe bizneseve.

## **IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJA**

Boll më me REKLAMAT! Qytetarët e Tiranës meritojnë zgjidhje! Brenda 6 mujorit të parë të mandatit do të kryet studimi i flukseve të lëvizjes së qytetarëve dhe do dëgjohen komunitetet vendore mbi nevojat që ato kanë në raport me transportin publik, vendparkimet e biçikletave në çdo lagje të qytetit. Sipas raportit të flukseve të qytetarëve, për ato më të rëndësishmet do të vendosen korsi të dedikuara të autobusëve elektrik dhe do të shihen mundësitë konkrete që të ndërtohet në bashkëpunim me partneret ndërkombëtar trami i Tiranës. Nuk duhet të harrojmë në fund se preferencat për transport të qytetarëve të Tiranës nuk duhen mohuar, sepse në demokraci nuk janë qytetarët që duhet të sillen siç do Bashkia, por Bashkia duhet të zbatojë preferencat e qytetarëve. Thënë ndryshe, nëse banorët e Tiranës preferojnë qarkullimin me automjete, atëherë Bashkia duhet të ndërtojë më shumë rrugë dhe të ruajë distancë më të gjatë midis pallateve. Suedia është e mirë për shijet e Suedezëve. Ta bëjmë Tiranën ashtu siç e duan qytetarët e saj. Ka ardhur koha t'i dëgjojmë ata!

## **V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE**

- 1- Në të gjitha lagjet e reja që do të ndërtohen në Tiranë do të jetë domosdoshmërisht prezenca e një parku, i cili do të përmirësojë cilësinë e ajrit, dhe lidhjet me pjesët e tjera të qytetit do të jenë të garantuara nga rrugë të gjera me së paku 4 korsi, trotuare, rrugë për biçikletat dhe linja të shpeshta autobusësh.
- 2- Të gjithë autobusët urban do të kenë në pikat e ndalesës së tyre oraret e mbërritjes dhe të nisjes, si dhe vonesat relative në tabelat elektronike të lidhura me vendndodhjen e autobusëve. Në oraret me trafik më të rënduar do të shtohet numri i autobusëve. Në çdo pikë ndalimi të autobusëve qytetarët do të kenë mundësinë të shohin hartat e udhëtimit të autobusëve dhe pikat e shkëmbimit me linjat e tjera. Bileta do të jenë të subvencionuara për ish-të përndjekurit politikë.  
Në të njëjtën kohë do të hartohen, aprovohen dhe implementohen abone 3 mujore, 6 mujore dhe 1 vjeçare për mjetet publike për të gjithë qytetarët e Tiranës të cilët nuk do të kenë detyrimin të mbajnë radhë të gjata në kioskat e shekullit të kaluar, por do të kenë mundësinë t'i blejnë këto abone online.
- 3- Ndërtimi i parkimeve shumëkatëshe mbi dhe nën nivelin e tokës për 4 pikat hyrëse në Tiranë. Te mbikalimi i Kamzës, në hyrje të Kombinatit, pranë TEG-ut dhe në fillimin e rrugës së Arbrit, me kosto ditore prej 200 lekë. kuponin i marrë në këto parkime do të vlejë edhe si biletë ditore për qytetarët, që të lënë automjetet në këto pika dhe të vijojnë udhëtimin drejt qytetit me mjetet publike.

# **1 E-TICKET**

e-transport . Biletë unike elektronike. Formatimi i stacioneve të kronometruara urbane. Pesë parkime të mëdha publike në hyrje të Tiranës.



# 13 TRASHËGIMIA

Shpallja monument kulture i katër zonave; Zona e trashëgimisë otomane, e paraluftës, e komunizmit dhe shpallja muze e ansamblit arkitekturor qendra

# 13. TRASHËGIMIA

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Politikat mbrojtëse të dobëta. Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore të identifikuar në rang Bashkie, deri në 2016 ishin 302 monumente kulture, në zonën urbane të Tiranës gjendeshin 264 prej tyre, ndërsa në zonat e tjera urbane dhe rurale të qarkut ishin 39 monumente kategori e parë dhe e dytë. Në vitin 2022, Bashkia Tiranë ka humbur rreth 20% të objekteve të trashëgimisë kulturore të shpallura monument kulture. Nga totali i mbetur më shumë se 50% e tyre rrezikojnë shembjen si pasojë e braktisjes/degradimit dhe presionit ekonomik të shtuar në qytet. Politikat mbrojtëse të qeverisjes qendrore për trashëgiminë kulturore janë evidentuar si të pamjaftueshme për të siguruar jetëgjatësinë dhe rijetëzimin e trashëgimisë kulturore materiale të ndodhur si në zonat urbane, ashtu edhe rurale.
- 2- Tirana humbi Ansamblin Monument Kulture. Reduktimi i Qendra Historike me 50% të sipërfaqes së saj me vendimin nr. 582, datë 3.10. 2018. VKM e 2018 pasoi me dy ndryshime thelbësore:  
Si fillim Qendra e Tiranës nuk është më Ansambël Monument Kulture terminologji që sipas ligjit të 2018 është përditësuar në “Ansambël historik urban”. Pse ka rëndësi ky ndryshim? Sepse i këputi ndërlidhjen që evidenton ansambli urbanistiko-arkitektonik duke i hapur rrugë ndërhyrjeve me kulla në qendër.  
Nga ana tjetër, zona e mbrojtur që VKM përcaktoi si një territor i përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, “roli i së cilës është mbrojtja e vlerave të këtyre pasurive kulturore dhe sigurimi i dritës, perspektivës, peizazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku” u përdor nga Bashkia Tiranë për truall ndërtimi të ndërtimeve të reja shumëkatëshe.
- 3- Plani si instrument spekulimi. Që pas miratimit të planit të Tiranës 2030 në vitin 2016, në qytetin e Tiranës kanë humbur statusin ligjor 46 objekte ose 17.5% e monumenteve të kulturës, nga të cilat deri në 2022 janë evidentuar se janë shembur 21 prej tyre ose 8%. Me këtë ritëm, deri në 2030, numri pritet të të rritet në mënyrë eksponenciale. Tirana pritet të humbasë rreth 40%-50% të objekteve trashëgimi kulturore, aktualisht të evidentuara dhe shpallura si monument kulture. Si shkaktari kryesor është evidentuar plani i përgjithshëm vendor i Tiranës, i cili edhe pse e ka në objektivat e tij ruajtjen e trashëgimisë është keqpërdorur si instrument duke u shndërruar nga rregullues i territorit në instrument spekulues me territorin.
- 4- Shkatërrimi, zhvillim i paqëndrueshëm. Qyteti i Tiranës vërehet të jetë shndërruar në arenën ku po zhvillohet konflikti midis zhvillimit urban dhe ruajtjes së trashëgimisë materiale. Ky model zhvillimi konsiderohet i paqëndrueshëm, pasi e ka shndërruar vendbanimin në një laborator urban në të cilin u shfaqën dhe u zhvilluan me shpejtësi dukuritë e zhvendosjes dhe deformimit të peizazhit historik urban, shpesh duke fshirë shtresat të tëra të ndërtimit të qytetit. Rezultati i këtyre ndërhyrjeve është fshirje e kujtesës kolektive dhe shkëputje me historinë e vendit.
- 5- Fenomenet natyrore si fatkeqësi kulturore. Monumentet e trashëgimisë kulturore materiale të ndodhura si brenda edhe jashtë territorit urban të Tiranës në zonat pranë ose brenda fshatrave kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë jashtë vëmendjes së autoriteteve qendrore dhe lokale. Tërmeti i 2019 shpërfaqti mungesën e restaurimeve dhe mirëmbajtjeve të monumenteve, si kalatë, kullat dhe muret antike të evidentuara dhe shpallura si monumente kulture kategori e parë. Kështu, nga 265 monumente kulture të inspektuara pas tërmetit, 25 kanë pësuar dëmtime, nga të cilat 10 janë të shkallës së 3-të dhe 15 të shkallës së dytë të dëmit. Tërmeti u keqpërdorur si fatkeqësi, duke justifikuar shkatërrimin e disa prej monumenteve brenda qytetit. Ndërsa restaurimet e 5 monumenteve të dëmtuara, po zhvillohen nga UNOPS në projektin EU4culture, me fondin prej 50 milionë eurove.

\*Shembull spekulimi me monumentet: Objekti i ATSH-së, e cila ishte monument kulture në pronësi të Bashkisë Tiranë, u shemb me justifikimin se ishte e dëmtuar nga tërmeti, edhe pse nuk gjendet në asnjë nga raportet e objekteve të kësaj kategorie. Dokumentet tregojnë se godina është pjesë e një tenderi prej 30 milionë eurosh, duke u futur në listën e 14 objekteve arsimore që do të ndërtohen në Tiranë në kuadër të programit të rindërtimit. Objekti është i vetmi në listë që nuk ka lidhje me arsimin e as nuk do të shndërrohet në godinë arsimore. Objekti i ish-ATSH jo vetëm që vijon të jetë pjesë e listës së Monumenteve të Kulturës në Tiranë, por gjithashtu mungon dhe në listën zyrtare të monumenteve të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit. Vendimi i Këshillit të Bashkisë për prishjen e ndërtesës datoi në nëntor 2020, megjithatë dokumentet e prokurimit për projektin e ri datojnë në mars dhe gusht 2019, plot tetë muaj para tërmetit që supozohet se e ka bërë ndërtesën të pasigurt.

## **II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT**

- 1- Zona mbrojtëse e Qendrës historike të Tiranës, është shndërruar në kantier ndërtimi, edhe pse në kuptimet ligjore është një territor i përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, roli i së cilës është mbrojtja e vlerave të pasurive kulturore dhe sigurimi i dritës, perspektivës, peizazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku.
- 2- Plani i përgjithshëm vendor nuk merr në konsideratë praninë e objekteve monument kulture gjatë fazave të përpilimit të PDV-ve, duke shërbyer si nxitës i shkatërrimit të objekteve.
- 3- Fshirja nga territori i shtresave urbane historike ka rezultuar me zhdukje të kujtesës kolektive të qytetit dhe humbje të lidhjeve me historinë.
- 4- Mungesa e një vizioni për të zhvilluar sektorin e trashëgimisë kulturore në shkallë bashkie, duke e fokusuar vëmendjen në një rreze prej 500 metrash nga sheshi Skënderbej.
- 5- Mungesa e vëmendjes dhe trajtim jo të barabartë të tipologjive të ndryshme të trashëgimisë kulturore ka rrudhur deri në mpakje potencialin ekonomik, social dhe mjedisor që ka kultura materiale në zonat urbane dhe rurale.

## **III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJIA E SEKTORIT**

Trashëgimia kulturore materiale dhe jomateriale si një tërësi vlerash kulturore, mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, ka rëndësi shkencore dhe kulturore, vlerat e të cilës janë “pasuri publike” dhe gëzojnë mbrojtje ligjore nga strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore në interesin më të mirë të shqiptarëve. Strukturat e qeverisjes vendore në bashkëpunim edhe me subjektet private nuk duan të krijojnë kushte për garantimin e aksesit të barabartë të publikut tek vlerat kulturore që transmetohen nëpërmjet pasurive kulturore, ku njëri nga kushtet është transparenca në menaxhimin e aktiviteteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe decentralizimi i administrimit dhe financimit të veprimtarive, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Këto detyrime rrjedhin nga legjislati në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe konventat ndërkombëtare që shteti shqiptar ka firmosur dhe ratifikuar.

## **IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJIA**

Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të bashkëpunojë me pronarët dhe poseduesit e pasurive kulturore në pronësi private, si edhe më tej me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore, sipas parashikimeve të legjislati për trashëgiminë kulturore. Njësia e qeverisjes vendore në zbatim të detyrimeve ligjore duhet të zhvillojë politika dhe strategji për mbështetje me fonde për hulumtimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, ekspozimin, prezantimin dhe përhapjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe asaj jomateriale, kjo e fundit si shprehje e identitetit kulturor kolektiv, të përfshira në konventat e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.

## V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

1. Shpallja e disa komplekseve historike arkitektonike dhe urbane të ndodhura brenda qytetit të Tiranës, komplekse të cilat përfshijnë një tërësi ndërtimesh të periudhave të njëjta por edhe të ndryshme historike, të cilat kanë një lidhje të ngushtë funksionale dhe kulturore ndërmjet tyre dhe zhvillojnë peizazhin kulturor si pjesë e territorit. Rishikimin e planeve të detajuara vendore (PDV) për këto komplekse të trashëgimisë kulturore, me qëllim ruajtjen e pasurive kulturore të paluajtshme, si edhe vlerësim, në parim, të lejeve zhvillimore.
2. Strategji për zhvillimin e sektorit të trashëgimisë kulturore të Tiranës, me katër objektiva kryesore-P2MR:  
Parandalimi, si tërësia e veprimeve për kufizimin e situatave të rrezikut të lidhura me pasurinë kulturore në kontekstin e saj. Kjo synon garantimin e jetesës dhe ripërtëritjes së trashëgimisë.  
Mbrotjtja e pasurive kulturore materiale dhe jomateriale të qytetit, objektiv, i cili synon zhvillimin e një sistemi masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit;  
Mirëmbajtja e pasurive kulturore materiale dhe jomateriale të qytetit, objektiv, i cili synon të gjitha masat praktike dhe teknike që duhen ndërmarrë referuar standardeve europiane, në mënyrë që pasuria kulturore të mbahet në ato lloj kushtesh e standardesh pa dëmtuar vlerat kulturore duke asistuar pronarët e tyre me konsultime, ekspertiza dhe rekomandime për përfitimin e granteve për mbështetje financiare.  
Rijetëzimi i pasurive kulturore materiale, duke bashkëpunuar me biznesin lokal, pronarin apo poseduesin e pasurisë me objektiv dhënien në përdorim të pasurisë kulturore për funksione social-kulturore dhe shërbime me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore.
3. Zhvillimi i Katalogut të Pasurive Kulturore për qytetin, me synim shpalljen e tyre pjesë e pasurisë kulturore të territorit urban-rural të Tiranës. Ky katalogim synon ndërtimin e bazës së të dhënave në nivel bashkie, nëpërmjet Sistemit Digjital të Pasurive Kulturore të hapur për të gjithë komunitetin. Katalogu zhvillohet në bashkëpunim me komunitetin e qytetit, fshatit dhe çdo banor i cili ka njohje dhe lidhje të drejtpërdrejta apo të tërthorta mbi pasurinë kulturore.

# 4 ZONA


Shpallja monument kulture i katër zonave; Zona e trashëgimisë otomane, e paraluftës, e komunizmit dhe shpallja e muze e ansambllit arkitekturor qendra. Në bashkëpunim me komunitetin.





# 14 TERRITORI

Zonimi i Tiranës: Zona rekreative/industriale spitalore universitare. Përqëndrimi i kullave me infrastrukturë të përshtatshme në bulevardin e ri



# 14. TERRITORI

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

Nëse kryejmë një përshkrim të territorit urban, mund të dallojmë qartë zonat e qendrës, periferisë dhe zonës suburbane. Tirana mbetet një qytet monocentrik, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të decentralizuar territorin urban. Në kohën e monizmit gjatë fazës së parë të industrializimit, u tentua krijimi i qendrave të reja mbi bazë industriale si Kombinati i Tekstileve, Kinostudio, por pa rezultate të bindshme, për shkak të monofunksionalitetit të tyre, infrastrukturës së dobët dhe mungesës së vlerave urbane në to. Shpejt ky princip do të braktisej duke i lënë vend centralizimit radikal i cili shkoi paralel me politikën totalitare, duke shkaktuar vertikalizimin absolut në terma rëndësie të territorit urban. Tranzicioni solli degradim të mëtejshëm të qendrave periferike me reduktim të prezencës së institucioneve publike, varfërim të resurseve njerëzore, rritje të pasigurisë publike, duke amplifikuar më tej diferencën me qendrën e qytetit e cila vazhdoi të rezonojë mëvetësinë e saj triumfuese.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

Problematikat e Qendrës. Teksa kryeqyteti rritet në mënyrë të pandalshme duke dyfishuar e trefishuar popullsinë, problematikat e përqendrimit monocentrik bëhen gjithmonë e më evidente përsa i përket trafikut, ndotjes, zhurmës por edhe diferencës së madhe të rentës imobiliare nga qendra në periferi. Periudha e tranzicionit e gjeti Tiranën pa një vizion të përgjithshëm zhvillimi. Për mëse 20 vjet zhvillimi u adresua në mënyrë fragmentare nëpërmjet planeve pjesore, të cilat deformuan në mënyrë sistematike çdo strukturë urbane duke e bërë qendrën e kryeqytetit pre të spekulimit ndërtimor e duke rritur gjithmonë e më shumë deficiencën e infrastrukturës ekzistuese kryesisht të trashëguar.

Plani rregullues i vitit 2011 për herë të parë tentoi të adresojë problematikat e rritjes urbane nëpërmjet aplikimit të policentrizmit bazuar mbi përforcimin dhe theksimin e atributëve urbane në disa zona të kryeqytetit duke i transformuar ato në qendra komplementare në territor. Kjo ide, e risjellë edhe nëpërmjet planit pasues të vitit 2017 - Tirana 2030, ende sot gjendet e paimplementuar. Fatkeqësisht plani i 2017-ës nuk shërbeu më shumë se një justifikim për spekulime të mëtejshme me densitete të pakontrolluara në zona preferenciale dhe mungesë vëmendje për pjesën tjetër.

Zhvillimi mbi principe të barazisë, që duhet të sigurojë pushteti lokal nëpërmjet planit dhe programeve të detajuara për zona, gjendet nën presion nga vendimmarrja e pushtetit qendror i cili vepron paralelisht me leje të miratuara në KKT sipas prioriteteve subjektive dhe pa koordinim me pushtetin lokal. Efektet rezultojnë të njëjta me ato të planeve pjesore.

Aksi historik i Tiranës, në më pak se 5 vite u bë dëshmitar i një deformimi të paprecedent, ku në emër të zhvillimit aparent nëpërmjet arkitekturës u debutua e gjithë propaganda shtetërore. Qytetarët e Tiranës janë dëshmitar të përgjysmimit të qendrës së qytetit si në aspektin e territoreve të lira të zëna nga ndërtime shumëkatëshe, po ashtu edhe në aspektin proporcional, të ndryshimit të menjëhershëm të dimensionit hapësinor, me një goditje të rëndë ndaj memorjes kolektive, duke i bërë njerëzit të ndihen si në kuti. Pavarësisht se rritja e paprecedent nuk është vënë ende në akt, pasi shumë prej ndërtimeve të reja janë ende të pambaruara e të papopulluara, efektet e përqendrimit - politikave të vertikalizimit total, tashmë kanë filluar të evidentojnë pasojat si:

- Rritje e diferencës së rentës imobiliare qendër-periferi;
- Mbipopullimi i qendrës dhe boshatisje e periferisë;

- Trafik i rënduar për automjete dhe këmbësorë;
- Ndotje ambientale përfshi ajrin, zhurmat;
- Përqendrim dhe përkeqësim i shërbimeve publike vendore.

Problematikat e periferisë. Konglomerati urban i periferive të Tiranës përbëhet kryesisht nga banesa të ndërtuara gjatë monizmit, periudhës së tranzicionit dhe viteve të fundit. Nga përmbajtja ndërtimore këto zona mund të dallohen qartë nga njëra-tjetra, ndërsa problematikat që ato ndajnë janë shumë të ngjashme. Periferia e Tiranës gjendet prej kohësh në një status degradimi të thellë ndërtimor, infrastrukturor dhe shoqëror. Më tepër se gjysma e popullsisë kryeqytetase jeton në periferi dhe konkretisht pjesa më aktive e tij.

Periferia është gjithashtu hapësira që ka njohur rritjen më të madhe gjatë periudhës së tranzicionit dhe në vazhdim. Por, rritja e saj ka qenë tipike spekulative e karakterizuar prej literaturës së fushës si “njollë vaji”, në kuptimin e shpërhapjes së pakontrolluar e pa një orientim të qartë strategjik. Ky fenomen vihet re si në zonat e ndërtuara gjatë 20 vjeçarit të fundit të monizmit, ashtu edhe në shpërhapjen që iu bë qytetit gjatë tranzicionit. Periferia socialiste e ndërtuar në cilësi të dobët, kryesisht me punë vullnetare, me ndërtesa të parafabrikuara dhe infrastrukturë pothuaj inekzistente, u përkeqësua akoma më tej gjatë tranzicionit me mungesën e mirëmbajtjes, zënien e hapësirave ndërmjet ndërtesave, modifikimet personale të ambienteve pavarësisht adaptueshmërisë së ulët që paraqet kjo tipologji. Ndërsa ndërtimet e mëvonshme të prirura drejt fitimit nëpërmjet spekulimit, karakterizohen prej dendësisë së madhe, mungesës së hapësirës publike dhe cilësisë së ulët ndërtimore dhe deficensës energjitike.

Në aspektin e administrimit, në të dyja kategoritë vihet re neglizhenca e institucioneve vendore përsa i përket dhënies së shërbimeve pavarësisht faktit që edhe banori i periferisë është njësoj taksapagues. Vitet e fundit, sidomos pas tërmetit të 2019-ës, është hedhur ideja e zëvendësimit të konglomeratit ndërtimor të vjetruar, duke filluar prej zonës së Kombinatit e duke e shtrirë ndërhyrjen në të gjithë qytetin. Pavarësisht nevojës emergjente për konsolidimin apo zëvendësimin e fondit ndërtimor të periudhës së socializmit, procesi has në problematika që kanë të bëjnë me administrimin e këtij operacioni dhe mungesën e transparencës nga ana e pushtetit vendor ku bien dyshime mbi qëllimet spekulative në favor të klientelës ndërtuese. Si konkluzion problemet e periferisë mund të përmbledhen:

- Pamundësia e krijimit të një identiteti dhe konkurrueshmërie urbane;
- Lidhje të dobëta me infrastrukturën kryesore urbane;
- Mungesë mirëmbajtje dhe amortizim i fondit ndërtimor dhe infrastrukturës;
- Prezencë e pamjaftueshme e autoriteteve vendore ligjzbatuese;
- Përkeqësim i standardeve të urbanizimit në lidhje me infrastrukturën e shërbimeve.

Problematikat e zonës suburbane. Me futjen e konceptit “Tirana e Madhe”, në thelb kemi të bëjmë me qendërzim të shërbimeve vendore me shtrirje rajonale brenda territorit urban, duke zvogëluar rolin e komunave të mëparshme e duke i dhënë kontroll të plotë mbi territorin Bashkisë. Ky ndryshim thelbësor në menaxhimin e territorit, i cili është vënë në akt prej disa vitesh, duhej të kishte kontribuar në rritjen e barazisë së ish-komunave dhe fshatrave me qendrën urbane, shtim të kapaciteteve të institucionit qendror vendor dhe rritje të bashkëveprimit me njësitë bashkiake të atashura. Planifikimi mbi bazë territori është hapi i duhur drejt sigurimit të një kohezioni më të mirë ndërmjet qytetit, zonave rurale dhe natyrës. Nga ana tjetër, qyteti është një entitet dominues nga pikëpamja e tendencës duke rrezikuar të urbanizojë territorin natyror rreth tij, denatyrizojë karakteristikat e zonave rurale duke eksportuar prodhimin e tij kryesor që është betoni, ndërtimin duke promovuar fenomenin e shpërhapjes me banesa unifamiljare. Ndërkohë që qyteti shfaq boshllëqe për sa i përket furnizimit me produkte cilësore bujqësore të cilat shpesh sigurohen nga zona të largëta apo prej importit me çmime të shproporcionuara, pjesa më e madhe ish-territoreve bujqësore rreth tij gjenden të braktisura apo në pritje të një leje ndërtimore. Zonat e urbanizuara të ish-komunave vuajnë shpopullimin, ndërsa etja për ndërtim e zënia e territoreve bujqësore është e papërmbajtshme duke argumentuar mungesën e një strategjie gjithëpërfshirëse territoriale. Për të përmbledhur problematikat, mund të theksohet:

- Mungesa e kohezioni midis zhvillimit të territorit urban dhe atij rural;
- Përkeqësimi i aksesit ndaj shërbimeve publike, ujë, energji, transport urban;
- Mungesë e vizionit për zhvillimin rural.

### **III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJIA E SEKTORIT**

Zhvillimi klientelist i pabarabartë mbizotëron mbi politikat gjithëpërfshirëse e me bazë shkencore mbi territorin, duke pamundësuar një zhvillim të qëndrueshëm që sheh drejt një kohezioni midis njeriut dhe ambientit ku jeton. Prioritete të gabuara zhvillimi me interes të përkohshëm e afatshkurtër e jo zgjidhje afatgjatë që përmirësojnë në mënyrë domethënëse kushtet e përgjithshme të jetesës dhe përdorimit të territorit.

### **IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJIA**

Riorientim i strategjisë mbi politikat urbane dhe territoriale drejt gjetjes së një raporti më organik ndërmjet zhvillimit, ruajtjes së resurseve njerëzore, natyrore dhe kulturore duke siguruar një lidhje më të fortë ndërmjet potencialeve lokale dhe ekonomisë së tregut. Trajtimi i qytetit dhe territorit si një fakt shkencor që shkon përtej interesave politike të momentit, si produktin më të madh që shoqëria i lë trashëgim brezave që do të vijnë.

### **V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE**

1. Zhvillimi i poliqendrave me bazë rajonale, duke siguruar shtrirje horizontale të zhvillimit dhe duke krijuar mundësi të reja për investime më të qëndrueshme e më afër njerëzve. Një axhendë e veçantë për rikonstrukcionin e periferisë.
2. Diversifikim i ekonomisë urbane drejt sektorëve të teknologjisë dhe inovacionit për ta bërë Tiranën tërheqëse për investime smart e me impakt të ulët mjedisor;
3. Përmirësim i lidhjeve urbano-rurale jo vetëm përmes infrastrukturës, por edhe përmes sigurimit të një kohezioni nëpërmjet implementimit të një ekonomie cirkulare.

# **5 ZONA URBANISTIKE**

Zonimi i Tiranës: Zona rekreative/industriale spitalore universitare. Përqendrimi i kullave me infrastrukturë të përshtatshme në bulevardin e ri.



# 15 SPORTI

Krijimi i abonesë bashkiake për sportin dhe subvencionim dhe abonim për aktivitetet sportive

# 15. SPORTI

## I – TË DHËNAT SASIORE KYÇE PËR SEKTORIN

- 1- Bashkia e Tiranës shpenzon për aktivitetet rekreative dhe sportet 1.5 milion euro në vit ose vetëm 0.8% të shpenzimeve në buxhetin e vet. Kjo normë është ndjeshëm më e ulët në raport me Bashkinë e Prishtinës, Shkupit apo Podgoricës.
- 2- Rinia e qytetit, ashtu si moshat e treta, kanë pak ose aspak mjedise publike ku mund të ushtrojnë aktivitete sportive dhe rekreative dhe i drejtohen qendrave private, ata që kanë mundësi ekonomike!
- 3- Niveli i obezitetit te fëmijët dhe adoleshentët në Tiranë është mjaft i lartë ndërsa për obezitetin e grave Shqipëria është vendi i tretë në Kontinentin Europian.
- 4- Një pjesë e mirë e personave që ndjekin një dietë të ekuilibruar dhe kurojnë trupin e tyre janë të detyruar të ndjekin palestrat private dhe qendrat sportive me pagesë.
- 5- Nga intensiteti i ulët i aktiviteteve sportive, sidomos të sporteve në grup, të rinjtë kanë tendencën të kenë pak besim dhe bashkëpunim te njëri-tjetri dhe një pjesë e tyre ka krijuar tendenca që e lidhin atë me vetminë dhe mosbesimin në raport me shoqërinë.

## II – PROBLEMATIKAT KRYESORE TË SEKTORIT

- 1- Aktivitetet sportive në Tiranë janë pak të financuara dhe shumë nga eventet apo pjesëmarrjet përballohen nga privatët që sponsorizojnë nga fondet personale të individëve.
- 2- Në Tiranë sport nuk bëhet, por sporti shikohet në çdo lokal dhe pallat të qytetit dhe, ndonëse të jashtëligjshme, bastet sportive vijojnë punën e tyre duke devijuar kështu fonde që do të përdorshin më mirë në aktivitetet sportive të qytetit.
- 3- Fushat sportive në Tiranë dhe mjediset publike në përgjithësi janë gërryer dhe shkatërruar duke u lënë vend parkimeve të makinave, pallateve dhe privatizimeve drejt jo-pronarëve.

## III – KRITIKA RRETH IDESË, FILOZOFISË, FRYMËS AKTUALE DHE E ARDHMJA E SEKTORIT

Veliaj vepron në mënyrë të përciptë edhe në sektorin e sportit. Konkretisht, ai inauguron mjedise të gjelbra aty ku gjelbërim kishte edhe më parë, siç është rasti i parkut të liqenit, ku bëhen parqe aty ku parqe dhe fusha kishte. Veliaj mburret se ndërton palestra në mjediset e shkollave aty ku me parë kishte fusha sporti dhe konkretisht fushat e sportit pranë Qytetit Studenti tani i ka bërë parkim autobusash, ndërkohë që fusha e futbollit pas stadiumit kombëtar tani është një parkim i rëndomtë makinash. Nëse vijon kështu, Veliaj do të inaugurojë stadiumin “Selman Stermasi”, ndonëse është ndërtuar prej gjysmëshekulli!

## IV – ALTERNATIVA E KËSAJ FRYME DHE E ARDHMJA

Programi i Partisë Demokratike për Sportin në Tiranë shpreh ambicien për një qytet aktiv me të rinj energjik, për një shoqëri vitale dhe fizikisht të shëndetshme. Synimi ynë është që të rinjtë të ndiejnë argëtimin e sportit

dhe vlerat që përcillen nëpërmjet agonizmit dhe bashkëpunimit duke krijuar një shoqëri gjithëpërfshirëse. Për këto arsye, kemi misionin ta shikojmë sportin si element përmirësues në jetën e përditshme të qytetareve të Tiranës dhe ta vlerësojmë atë edhe nga pikëpamja ekonomike dhe institucionale, duke aprovuar vendime nëpërmjet Këshillit Bashkiak që synojnë dyfishimin e buxhetit për sportin.

## V – TRI PREMTIMET & PROPOZIME KONKRETE

1. Bashkia e Tiranës do të jetë tërësisht e angazhuar me financimin dhe mbështetjen e Klubit të Sportit Tirana, në mënyrë të tillë që skuadra më përfaqësuese e kryeqytetit, në agonizmin e vet të tejkalojë përmasat kombëtare dhe të ballafaqohet pa frikë me ekipet më të mira të rajonit.
2. Bashkia Tiranë do të shpërndajë për çdo qytetar të kryeqytetit mbi moshën 16 vjeç SportCard, thënë ndryshe: një kartë plastike e cila do t'u lejojë qytetarëve të futen në mjediset sportive publike dhe të kenë ulje në çmimet e mjediseve sportive private. Diferenca e çmimit do të subvencionohet nga ana e Bashkisë.
3. Bashkë me 5 parkingjet e reja, 5 tregjet e reja, do të ndërtohen edhe 5 komplekse sportive në 5 pikat hyrëse të qytetit. Këto komplekse do të kenë mjediset e nevojshme për të ushtruar sportet më të praktikuara si futbollit, volejbollit, basketbollit etj.

# 1 KARTË

Krijimi i abonesë bashkiake për sportin dhe subvencionim dhe abonim për aktivitetet sportive.

# 15 PREMTIMET KRYESORE

- 1** **ARSIMI PARAUNIVERSITAR DHE UNIVERSITAR** “Tirana Student Friendly City”, krijimi i infrastrukturës për të pritur në Tiranë deri në 250.000 studentë shqiptarë dhe të huaj deri në vitin 2030.
- 2** **ARSIMI PARASHKOLLOR** “Hartë shkollore”, cerdhe dhe kopshte funksionale sipas parimit, jo më tepër se 15 min larg.
- 3** **ARTI** Zero taksë bashkiake për sipërmarrjet artistike dhe individët e pavarur që ushtrojnë aktivitete kulturore në Tiranë.
- 4** **BUJQËSIA** Çmonopolizim i tregut ushqimor. Hapjen e 5 tregjeve në pikat hyrëse të Tiranës dhe promovimi i ushqimit të “Kilometrit 0”
- 5** **EKONOMIA** Tri zona të lira ekonomike në zonën e Krrabës, Arbanës dhe Ndroqit për fuqizimin e ekonomisë së Tiranës. Inicim Ligj i ri i posaçëm për Tiranën.
- 6** **KUJTESA** Shpallja muze e “Burgut 313” vend i vuajtjes së dënimit. Vila 31 e Enver Hoxhës, qendër e edukimit dhe informimit për kujtesën e komunizmit.
- 7** **MJEDISI** Afrimi me normat europiane mjedisore, mbi ndotjen ajrit dhe ujit, deri në fund të mandatit.
- 8** **STREHIMI** Mundësi strehimi për të gjithë. Luftë çmimeve të larta të banesave. Ulje e taksës lokale nga 12% në 5 % ndaj ndërtuesve. Trasparençë financiare për ndërtimet në Tiranë.
- 9** **SHËNDETI** Infrastruktura dhe kujdes shëndetësor jo më larg se 15 minuta.
- 10** **TAKSAT** Taksa të ulëta, taksa për të gjithë. Përgjysmimi 50% i taksave aktuale. Eliminimi i gjysmës së tarifave, luftë informalitetit.
- 11** **TURIZMI** Turizëm gjatë gjithë vitit dhe i shumëllojshëm. Pesë vite zero taksë ndaj sipërmarrjeve turistike, bujtinave, start-up, etj.
- 12** **TRANSPORTI** e-transport . Biletë unike elektronike. Formatimi i stacioneve të kronometruara urbane. Pesë parkime të mëdha publike në hyrje të Tiranës.
- 13** **TRASHËGIMIA** Shpallja monument kulture i katër zonave; Zona e trashëgimisë otomane, e paraluftës, e komunizmit dhe shpallja e muze e ansambllit arkitekturor qendra.
- 14** **TERRITORI** Zonimi i Tiranës: Zona rekreative/industriale spitalore universitare. Përqëndrimi i kullave me infrastrukturë të përshtatshme në bulevardin e ri.
- 15** **SPORTI** Krijimi i abonesë bashkiake për sportin dhe subvencionim dhe abonim për aktivitetet sportive.

Ky program u hartua nga një grup prej 15 ekspertësh, me në krye Prof. Asoc. Mateo Spaho: Andi Lila; Ark. Urb. Dorianë Musai; Prof. As. Enriketa Papa; Prof. As. Taulanta Jupi; Gazment Goduzi; Gentian Muca; Dr. Mirela Karabina; Prof. Dr. Ndoc Faslia; Ramiz Metaliaj; Zak Topuzi